

Mbikëqyrja Parlamentare mbi Sektorin e Sigurisë dhe Çështjet Gjinore

Ilja Luciak



Rreth Autorit

Ilja Luciak është Profesor i Shkencave Politike në Institutin Politeknik dhe Universitetin Shtetëror të Virxhinias. Për 30 vitet e fundit ai ka kryer punë kërkimore në Meksikë, Amerikë Qendrore, Kubë, Peru dhe Kolumbi duke u përqendruar te çështjet gjinore, siguria dhe paqja. Ai ka punuar si konsulent për Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Fondin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Grave (UNIFEM), Zyrën e Këshilltarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Çështjet Gjinore dhe Përparimin e Grave (OSAGI) dhe Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida). Profesor Luciak mban titullin Juris Doctor nga Universiteti i Vjenës dhe ka doktoraturë nga Universiteti i Ajovas.

Redaktorë

Graziella Pavone, OSCE/ODIHR, dhe Megan Bastick, DCAF

Falënderime

DCAF, OSCE/ODIHR, dhe UN Women falënderojnë individët e shumtë të cilët kanë kontribuar në këtë projekt. Këtu përfshihen pjesëmarrësit në punëtorinë shqyrtuese që u mbajt në dhjetor 2018 në Gjenevë, dhe individët që shqyrtuan dhe dhanë kontribute në dokumentet e punës të këtij Moduli: Ornella Moderan, Nazli Yildirim Schierkolk, Jennifer Croft dhe Tiina Kukkamaa-Bah (ODIHR), Brad Orchard (UN Women) dhe Anna-Lena Schluchter dhe Lorraine Serrano (DCAF). Falënderim i veçantë shkon për Marta Ghittoni nga DCAF për koordinimin e përgatitjes së Paketës së Moduleve.

DCAF i shpreh mirënjohje shtetit të Zvicrës dhe Suedisë, si dhe Dfid nga Mbretëria e Bashkuar për mbështetjen e dhënë në përgatitjen e kësaj Pakete të Moduleve.

Kjo Paketë e Moduleve u botua me mbështetjen e Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSCE/ODIHR). Përmbytja nuk pasqyron medoemos politikën dhe qëndrimin e OSCE/ODIHR.

Botuar në Zvicër nga Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF).

DCAF Geneva
P.O. Box 1360
CH-1211 Geneva 1
Switzerland

Dizajni: Alice Lake Hammond

Foto në kopertinë: Pjesëmarrëse në Forumin Ndërkombëtar të Grave Udhëheqëse të bashkë-organizuar nga OSCE/ODIHR në Minsk, 21 qershor 2016 © BelTA.

© DCAF, OSCE/ODIHR, UN Women, 2019

Inkurajohet përdorimi, përkthimi dhe shpërndarja e këtij botimi. Mirëpo, ju lutemi që ta identifikoni burimin dhe t'i citoni materialet dhe të mos e ndryshoni përmbytjen.

Citoni si vijon: DCAF, OSCE/ODIHR dhe UN Women (2019) *"Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë dhe Çështjet Gjinore"*, nga Paketa e Moduleve për Çështjet Gjinore dhe Sigurinë (Gjenevë: DCAF, OSCE/ODIHR, UN Women).

ISBN 92-9222-479-4

Paketa e Moduleve për Çështjet Gjinore dhe Sigurinë nga DCAF, OSCE/ODIHR, UN Women

Ky Modul është pjesë e *Paketës së Moduleve për Çështjet Gjinore dhe Sigurinë* nga DCAF, OSCE/ODIHR, UN Women, e cila përfshin nëntë Module dhe një sërë Kumtesa të Politikave.

Modulet

1. Menaxhimi i Sektorit të Sigurisë, Reforma në Sektorin e Sigurisë dhe Çështjet Gjinore
2. Puna policore dhe Çështjet Gjinore
3. Mbrojtja dhe Çështjet Gjinore
4. Drejtësia dhe Çështjet Gjinore
5. Vendet e Privimit nga Liria dhe Çështjet Gjinore
6. Menaxhimi i Kufijve dhe Çështjet Gjinore
7. Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë dhe Çështjet Gjinore
14. Inteligjenca dhe Çështjet Gjinore
15. Integrimi i Çështjeve Gjinore në Hartimin dhe Monitorimin e Projekteve për Sektorin e Sigurisë dhe Drejtësisë

Kumtesat e Politikave

Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, Sektori i Sigurisë dhe Barazia Gjinore
 Agjenda Gratë, Paqja dhe Siguria nga Prizmi i Menaxhimit të Sektorit të Sigurisë
 Çështjet Gjinore, Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Kundërvënja ndaj Terrorizmit
 Çështjet Gjinore dhe Rregullimi i Sigurisë Private

Përveç këtyre, një Përmbledhje e Ligjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare dhe Rajonale lidhur me Barazinë Gjinore dhe Sektorin e Sigurisë dhe Drejtësisë është në dispozicion online.

Paketa e Moduleve për Çështjet Gjinore dhe Sigurinë bazohet në *Paketën e Moduleve për Çështjet Gjinore dhe Reformat në Sektorin e Sigurisë* nga DCAF, OSCE/ODIHR, UN-INSTRAW që u botua për herë të parë në vitin 2008. Modulet e mëposhtme të Reformës Gjinore dhe Sektorit të Sigurisë mund të përdoren së bashku me këtë Paketë të Moduleve.

8. Politikbërja e Sigurisë Kombëtare dhe Çështjet Gjinore
9. Mbikëqyrja nga Shoqëria Civile e Sektorit të Sigurisë dhe Çështjet Gjinore
11. Vlerësimi, Monitorimi dhe Evaluimi i Reformave në Sektorin e Sigurisë dhe Çështjet Gjinore
12. Trajnimi rreth Çështjeve Gjinore për Personelin e Sektorit të Sigurisë
13. Implementimi i Rezolutave për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Reformat e Sektorit të Sigurisë

They are home managers meaning they are capable to manage any organisation, even going into parliament.

It will make our nation stronger for

Balance

WOMEN BE DR

BECAUSE WOMEN SEE ISSUES FROM THE HEART- WE CAN DECIDE ON THE BEST INTEREST OF OUR COUNTRY

Women's voice need to be heard.

I Support Leadership for Women because we need Balance decision Making.

Women are also decision Makers

Prosperity & Accountability.


Women do only hard work in the Communities.
- Women because about their performance in Communities transparency

WOMEN IS A PILLAR IN OUR SOCIETY AND IS SUPPORTED BY OUR CUSTOM AND CULTURE.
WOMEN USUALLY HAD A POSITION AS CHIEF AND ALWAYS CARED FOR OUR RESOURCES WHICH NOW A DAY HAS BEEN SURPASSED BY MAN.

We should all be to make decisions, just

It has really affected my children. My daughter has sleepless nights. My son has started bullying other children.

Violence is not always visible. You may not see the bruises.



Përmbajtja

1. Pasqyrë	1
1.1 Audiencat për këtë Modul	1
1.2 Skica e këtij Moduli	1
2. Çështje mbikëqyrja parlamentare mbi sektorin e sigurisë?	5
2.1 Mbikëqyrja parlamentare.	5
2.2 Mbikëqyrja parlamentare mbi sektorin e sigurisë	5
2.3 Aktorët kryesorë brenda sistemit parlamentar	6
3. Pse është më rëndësi barazia gjinore dhe integrimi i perspektivës gjinore në mbikëqyrjen parlamentare mbi sektorin e sigurisë?	11
3.1 Përbushja e standardeve ligjore dhe normative ndërkombëtare dhe rajonale për barazinë gjinore.	12
3.2 Sigurimi i inkluzivitetit dhe gjithëpërfshirjes lidhur me nevojat e ndryshme të ligjeve dhe normave që kanë të bëjnë me sigurinë.	13
3.3 Arritja e buxhetimit të drejtë gjinor për sektorin e sigurisë	14
3.4 Kujdesi që vetë mbikëqyrja parlamentare ka diversitet dhe është gjithëpërfshirës	15
4. Si do të dukej mbikëqyrja parlamentare e sektorit të sigurisë që avancojnë barazinë gjinore dhe integron perspektivën gjinore?	19
4.1 Siguria dhe nevojat e sigurisë janë të përkufizuara në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe me perspektivë gjinore.	19
4.2 Legjislacioni dhe strukturat efektive për trajtimin e DhBGJ-së	20
4.3 Çështjet gjinore janë vënë në rrjedhat kryesore të buxhetimit	22
4.4 Parlamenti luan rol në planet kombëtare të veprimit për Agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria	23
5. Si mund ta ndihmojë mbikëqyrja parlamentare e sektorit të sigurisë avancimin e barazisë gjinore dhe integrimin e perspektivës gjinore?	27
5.1 Analiza gjinore e sektorit të sigurisë, përfshirë shqyrtimin e hollësishëm të buxhetit	27
5.2 Angazhimi i strukturave parlamentare gjinore në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë	29
5.3 Proceset gjithëpërfshirëse, puna afruese me shoqërinë civile.	30
5.4 Bashkëpunimi ndërmjet parlamenteve dhe institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut dhe institucioneve të ombudspersonit për të garantuar mbikëqyrje efektive mbi sektorin e sigurisë	31
5.5 Arritja e barazisë gjinore brenda parlamentit	32
6. Rekomandimet kryesore për integrimin e perspektivës gjinore në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë	37
7. Resurset plotësuese	39




SATA KABIA

Gender and Children's Affairs
Senta-Lore

COZARIA

MS. CATHERINE MARRINGTON



Shkurtesat

CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DP	Deputet i Parlamentit/Deputet
DhBGj	Dhuna në Bazë Gjinore
IKDNj	Institucioni Kombëtar i të Drejtave të Njeriut
IPU	Unioni Ndër-Parlamentar
LGBTI	Lezbike, Gej, Biseksual, Trans dhe Interseks
MB	Mbretëria e Bashkuar
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OZhQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
RSS	Reformat në Sektorin e Sigurisë

Evento Público

INFANCIA
SIN
CASTIGO



TENEMOS DERECHO A VIVIR SIN VIOLENCIA

Día: Martes 10 de Abril de 2012

Hora: 9:00 am a 12:00 am

Lugar: Plaza Simón Bolívar del Centro de la República



Hellen Tipian Rodríguez
EX ALCALDESA METROPOLITANA
DE LOS MUNICIPIOS ESCOLARES.

Dr. Luis Fernando Galarreta
Velarde
CONGRESISTA DE LA REPUBLICA

1. Pasqyrë

Ky Modul përcakton vizionin dhe strategjinë për të thelluar përpjekjet për integrimin e perspektivës gjinore dhe avancimin e barazisë gjinore në mbikëqyrjen parlamentare mbi sektorin e sigurisë. Mbikëqyrja parlamentare ka rëndësi thelbësore në krijimin e një sektori efektiv dhe llogaridhënës të sigurisë, i cili i përgjigjet nevojave të të gjithë qytetarisë. Mbikëqyrja e përgjegjshme gjinore është përgjegjësi e të gjithë anëtarëve të parlamentit (deputetëve të parlamentit), pavarësisht nga gjinia, përkatësia partiake apo formimi profesional.

Ky Modul shpjegon rëndësinë e mbikëqyrjes parlamentare mbi sektorin e sigurisë në arritjen e barazisë gjinore, dhe gjithashtu se si mund të përfitojë realizimi i sigurisë nga parlamentet që integrojnë perspektivën gjinore në mbikëqyrjen e tyre. Ai ka për qëllim të përcaktojë *çfarë* do të duhej të ishte mbikëqyrja parlamentare mbi sektorin e sigurisë që avancojnë barazinë gjinore dhe *si* parlamentet mund të mbikëqyrin në mënyrë efektive sektorin e sigurisë, përfshirë agjencitë e mbrojtjes, inteligjencës dhe ligj-zbatimit, në një mënyrë që integron perspektivën gjinore. Moduli ofron një varg shembujsh që ilustrojnë se si ndjekja e synimit për barazi gjinore e begaton funksionin e mbikëqyrjes parlamentare.

Ka kaluar më shumë se një dekadë nga botimi i dokumentit *Paketë e Moduleve për Çështjet Gjinore dhe Reformat në Sektorin e Sigurisë (RSS)* nga DCAF, OSCE/ODIHR dhe UN-INSTRAW, dhe shumëçka ka ndryshuar në këtë kohë. Kjo *Paketë e Moduleve për Çështjet Gjinore dhe Sigurinë*, e re, nga DCAF, OSCE/ODIHR dhe UN Women bën bashkë mësimet kryesore për promovimin e barazisë gjinore në siguri dhe drejtësi. Qëllimi i kësaj Pakete të Moduleve është të shkëmbejë praktikën e mira të reja dhe të sapo dala, të reflektojë se si janë arritur sukseset në rritjen e barazisë gjinore, dhe të ecet përpara duke menduar për integrimin e perspektivës gjinore në institucionet e sektorit të sigurisë dhe drejtësisë.

1.1 Audiencat për këtë Modul

Në audiencat kryesore për këtë Modul në nivel kombëtar përfshihen parlamentarët, stafi parlamentar dhe partitë politike. Përtej nivelit kombëtar, Moduli mund të përdoret nga anëtarët dhe stafi i organeve rajonale. Ky Modul mund të jetë i dobishëm edhe për organizatat e shoqërisë civile dhe të ombudspersonit, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut (IKDNj), kërkimtarët dhe akademikët që punojnë në pikëtakimin e sigurisë, parlamenteve dhe çështjeve gjinore.

1.2 Skica e këtij Moduli

Pjesa 2 shpjegon fushëveprimin dhe rëndësinë e mbikëqyrjes parlamentare mbi sektorin e sigurisë dhe aktorët kryesorë brenda sistemit parlamentar që janë të përfshirë në mbikëqyrje.

Foto: Pjesëmarrësit në një ngjarje publike të organizuar nga Kongresi në Peru diskutojnë ligjin për të ndaluar dhunën ndaj vajzave dhe djemve, 2012
© Congreso de la República del Perú.


Pjesa 3 demonstroi pse mbikëqyrja e përgjegjshme gjinore mbi sektorin e sigurisë është detyrim thelbësor për të gjithë parlamentarët. Fokusi është te rëndësia e respektimit të standardeve ndërkombëtare dhe rajonale ligjore dhe normative për barazinë gjinore; garantimi që ligjet dhe rregulloret në lidhje me sigurinë janë gjithëpërfshirëse dhe adresojnë nevojat e ndryshme; buxhetimi i barabartë; dhe sigurimi që mbikëqyrja parlamentare është e larmishme dhe gjithëpërfshirëse.

Pjesa 4 përqendrohet në atë se si do të dukej mbikëqyrja parlamentare mbi sektorin e sigurisë që avancohet barazinë gjinore. Moduli paraqet tiparet kryesore të mbikëqyrjes parlamentare që integron perspektivën gjinore në punën e vet. Në qasjet thelbësore përfshihet përkufizimi i sigurisë dhe i nevojave të sigurisë në mënyrë përfshirëse gjinore; adresimi gjithëpërfshirës i dhunës në bazë gjinore (DhBGj) ndaj grave dhe vajzave, si dhe ndaj burrave dhe djemve, në tërë diversitetin e tyre; njësimi i çështjeve gjinore në proceset e buxhetimit; dhe zbatimi i planeve kombëtare të veprimit (PKV) për Agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria.

Pjesa 5 përcakton mënyrat me të cilat parlamentet mund t'i qasen detyrës së tyre për integrimin e perspektivës gjinore në mbikëqyrjen mbi sektorin e sigurisë. Strategjitë kryesore janë analiza gjinore, përfshirë proceset buxhetore; angazhimi i strukturave parlamentare gjinore në mbikëqyrjen mbi sektorin e sigurisë; bashkëpunimi me shoqërinë civile, IKDNJ-të dhe institucionet e ombudspersonit; dhe ndërmarrja e hapave për të arritur barazinë gjinore brenda parlamentit.

Pjesa 6 paraqet rekomandimet kryesore për integrimin e perspektivës gjinore në mbikëqyrjen parlamentare mbi sektorin e sigurisë.

Pjesa 7 sugjeron resurse të tjera të dobishme.




Handwritten notes on a piece of paper:

- Government social welfare dept
- Health based women groups
- University < students + teachers
- NGOs (??) - use women (LMO)
- NGOs, social workers
- NGOs (Common, organization, networks)

Below this list, there are more notes:

- Health, Education, Environment, Energy
- NGOs < (Business)



2. Çështje mbikëqyrja parlamentare mbi sektorin e sigurisë?

Mbikëqyrja mbi sektorin e sigurisë është detyrë kryesore për të gjitha parlamentet. Kjo pjesë shpjegon pse është e nevojshme, çka është dhe si kryhet.

2.1 Mbikëqyrja parlamentare

Mbikëqyrja është funksion thelbësor i parlamenteve, krahas përfaqësimit, ligjvënies dhe kontrollit të procesit buxhetor. Mbikëqyrja parlamentare është një nga gurët themeltarë të demokracisë përfaqësuese: ajo do të duhej të jetë instrument i efektshëm i kontrolleve dhe ekuilibrave që e bën të jetë llogaridhënës pushtetin ekzekutiv. Monitorimi i fortë i ekzekutivit nga parlamenti është tregues i qeverisjes së mirë. Mbikëqyrja është mjete me të cilin parlamenti mund të sigurojë ekuilibër të pushtetit dhe të afirmojë rolin e vet si mbrojtës i interesave të popullit.

Objektivat themelore të mbikëqyrjes parlamentare janë promovimi i lirive dhe mirëqenies së popullit (përfshirë barazinë gjinore) dhe përmirësimi i qeverisjes. Proceset mbikëqyrëse vlerësojnë ndikimin e veprimeve të qeverisë në shoqëri, ndihmojnë për sigurimin e resurseve të përshtatshme për implementimin e programeve qeveritare, identifikojnë efektet pa dashje ose negative të politikave dhe veprimeve të qeverisë dhe monitorojnë përmbushjen e zotimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Proceset mbikëqyrëse përfshijnë vënien nën thjerrëz veprimet e propozuara të qeverisë, monitorimin e vazhdueshëm, rishikimin e veprimeve të ndërmarra, vlerësimin dhe hetimin.⁴ Për t'i mbajtur qeveritë të jenë llogaridhënëse, parlamentet duhet të kenë mandatin ligjor për mbikëqyrje, përveç zotësisë dhe pavarësisë për ta ushtruar atë.

Ndërsa mbikëqyrja është përgjegjësi thelbësore e të gjithë deputetëve, ata nuk e kanë vetëm këtë përgjegjësi. Parlamenti është një nga shumë aktorët e mbikëqyrjes brenda shoqërisë, megjithëse me rol unik kushtetues. Për të kryer mbikëqyrje efektive, parlamenti duhet të bashkëpunojë ngushtë me organet e tjera, në të cilat përfshihen institucionet e auditimit, IKDNj-të dhe organizatat e ombudspersonit, si dhe organizatat e shoqërisë civile. Për këtë do të bëhet fjalë më tej në Pjesën 5.

2.2 Mbikëqyrja parlamentare mbi sektorin e sigurisë

Mbikëqyrja parlamentare mbi sektorin e sigurisë përfshin mbikëqyrjen e forcave të armatosura dhe të sigurisë së shtetit (p.sh. forcat e armatosura, policia, xhandarmëria, roja presidenciale, shërbimet e inteligjencës, roja bregdetare, roja kufitare, autoritetet doganore dhe të emigracionit dhe njësitë rezervë ose lokale), burgjet, shërbimet e provës dhe shërbimet private të sigurisë. Me pak fjalë, sektori i sigurisë përbëhet nga të gjitha institucionet dhe subjektet që luajnë rol në garantimin e sigurisë së shtetit dhe popullit të tij.

Foto: Në maj 2014, Inclusive Security, në partneritet me N-Peace Network të UNDP-së, drejtoi një punëtori mbi avokimin dhe mobilizimin në Tajlandë për 19 gra nga një sërë sektorësh, duke përfshirë deputete të parlamentit të Mianmarit, pjesëtare të policisë në Nepal dhe udhëheqëse nga Indonezia. Punëtorja, e përshtatur enkas për gratë e përfshira në proceset e paqes, përgatiti pjesëmarrëset për të organizuar dhe trajnuar të tjerët për të avokuar për përfshirjen e grave © Inclusive Security.

Mekanizmat e mbikëqyrjes mbi sektorin e sigurisë janë krijuar “për të ofruar kontroll dhe ekuilibër të ndërsjellë të degëve të pushtetit që parandalon abuzimet e të drejtave të njeriut, për të kërkuar llogari nga ata që janë fajtorë për abuzime, për të bërë rekomandime për parandalimin e përsëritjes dhe për të siguruar që institucionet funksionojnë në mënyrë efektive dhe efektive, duke respektuar sundimin e ligjit”.² Vënia nën thjerrëz e mënyrës se si sektori i sigurisë e bën implementimin e politikës kombëtare rreth barazisë gjinore dhe Agjendës Gratë, Paqja dhe Siguria, është pjesë integrale e këtyre detyrave mbikëqyrëse.

Bazuar në funksionin e tyre përfaqësues, parlamentet janë në pozitë unike për t’i dhënë ose për t’i mohuar legjitimitetin demokratik vendimit të qeverisë për politikën e sigurisë dhe reformat e sigurisë dhe për të bërë bashkë qeverinë dhe qytetarët në formimin e dialogut kombëtar për sigurinë.³ Mbikëqyrja parlamentare, nëse është efektive, vendos kufij në pushtetin e ekzekutivit ose presidentit. Si e tillë, mbikëqyrja efektive është thelbësore për *qeverisjen e mirë të sektorit të sigurisë*, e karakterizuar nga preokupimi thelbësor për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit, përfshirë parimet e barazisë gjinore, dhe për zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror dhe ekonomik (shih Korniza 1). Parlamentet demokratike mbikëqyrin punën e sektorit të sigurisë në bazë të parimeve të ligjshmërisë, llogaridhënies, transparencës, pjesëmarrjes dhe përgjegjshmërisë ndaj qytetarisë.

Korniza 1: Mbikëqyrja parlamentare dhe arritja e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm

Në shtator 2015, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së adoptoi Agjendën e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ). Agjenda e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm pohon se parlamentet kombëtare luajnë rol vendimtar nëpërmjet ligjvënies, adoptimit të buxheteve dhe rolit të tyre në garantimin e llogaridhënies për sektorin e sigurisë.

Implementimi i OZhQ-ve kërkon një parlament gjithëpërfshirës, meqë gjithëpërfshirja është në thelb të OZhQ 16 (paqe, drejtësi dhe institucione të forta), dhe gjithashtu një parlament që përqendrohet në arritjen e OZhQ 5 për barazinë gjinore. Agjenda e vitit 2030 paraqet “edhe sfidë edhe mundësi për parlamentet që të zhvillojnë rolin e tyre duke punuar me qeveritë për të përmirësuar mirëqenien e të gjithë njerëzve” (IPU and UNDP, 2017: 11).

Shih Kumtesën e Politikave “The 2030 Agenda for Sustainable Development, the Security Sector and Gender Equality”.

Burimi: UN Department of Economic and Social Affairs (2015) “Transforming our world: The 2030 Agenda for Sustainable Development”, New York: UN DESA; IPU and UNDP (2017) “Global parliamentary report 2017 – Parliamentary oversight: Parliament’s power to hold government to account”, Tignieu-Jameyzieu: Courand et Associés, p. 11.

Në vendet që kalojnë nëpër tranzicion demokratik shpesh ka probleme të përhapura në sektorin e sigurisë. Institucionet e sektorit të sigurisë mund të lëngojnë nga mungesa e mekanizmave të llogaridhënies, nga korrupsioni dhe besimi i ulët i publikut. Vendet e tjera mund të vuajnë nga mungesa e resurseve dhe e mbikëqyrjes, korrupsioni i përhapur dhe korniza joadekuate parlamentare dhe gjyqësore. Për t’i adresuar këto probleme dhe për të forcuar qeverisjen e sektorit të sigurisë, shpesh është e nevojshme reforma e sektorit të sigurisë. Parlamentet luajnë rol thelbësor në reformat e sektorit të sigurisë (RSS). RSS ka dy përbërës: një normativ për të garantuar *qeverisje të mirë* të sektorit të sigurisë duke forcuar menaxhimin, llogaridhënien dhe mbikëqyrjen civile; dhe një praktik për të ndjekur efektivitetin dhe efikasitetin duke ristrukturuar sektorin dhe për të ndërtuar resurset njerëzore dhe materiale.

2.3 Aktorët kryesorë brenda sistemit parlamentar

Mbikëqyrja parlamentare mbi sektorin e sigurisë bëhet në shumë mënyra. Rol qendror kanë mekanizmat e parlamentit për shqyrtimin dhe aprovimin e buxheteve, dhe vënien në fuqi të legjislativitetit në lidhje me sektorin e sigurisë dhe mbikëqyrjen e implementimit të tij. Zotimet

* Qeverisja e sektorit të sigurisë dhe RSS shpjegohen më hollësisht në DCAF Backgrounder Series.

Lidhjet ndërmjet barazisë gjinore dhe qeverisjes së mirë të sektorit të sigurisë dhe RSS diskutohen më hollësisht në Moduli 1, “Qeverisja e Sektorit të Sigurisë, Reformat në Sektorin e Sigurisë dhe Çështjet Gjinore”.

e OSBE-së, për shembull, i referohen mbikëqyrjes parlamentare në çështjet ushtarake dhe të sigurisë kombëtare, gjegjësisht flasin për, “aranzhime efektive për mbikëqyrjen legjislative të të gjitha këtyre forcave [d.m.th. forcat ushtarake dhe paraushtarake, shërbimet e sigurisë së brendshme dhe shërbimet e inteligjencës, dhe policia], shërbimeve dhe aktiviteteve” dhe “miratim legjislativ të shpenzimeve të mbrojtjes”.⁴ Parlamenti mund të monitorojë, hetojë dhe raportojë mbi politikën e sektorit të sigurisë, personelin, financat, operacionet dhe prokurimin e pajisjeve dhe sistemeve të armatimit. Në disa kontekste, parlamentet kanë mandatin të shqyrtojnë hollësisht, të vendosin veto ose të aprovojnë emërimet e larta brenda institucioneve të sektorit të sigurisë.⁵

Ekziston një larmi aktorësh kryesorë brenda sistemit parlamentar që kontribuojnë në mbikëqyrjen mbi sektorin e sigurisë.

- ◆ *Parlamentarët*, ose deputetët, janë përfaqësues të zgjedhur nga votuesit për parlamentin e vendit. Ata do të duhej të sigurojnë që shqetësimet e qytetarëve të merren parasysh në politikën lidhur me sigurinë, të propozuara nga ekzekutivi. Ata mund të iniciojnë dhe shqyrtojnë projektligje, të marrin në pyetje anëtarët e ekzekutivit në seancat parlamentare dhe të kërkojnë para-hetime dhe hetime zyrtare. Duke shërbyer si kanal për publikun, parlamentarët mund të mbajnë seanca dëgjimi publik dhe t'i ofrojnë grupeve të shoqërisë civile informacione të rëndësishme. Në disa raste, ligjvënësit individualë përdorin takimet në formë të tribunave qytetare për të diskutuar politikën e qeverisë me zgjedhësit e tyre. Ky funksion i fundit, duke shërbyer si urë lidhëse për publikun - qoftë në nivelin e partive politike apo të ligjvënësit individual - forcon në masë të madhe legjitimitetin e vendimmarrjes parlamentare për çështje të sigurisë.
- ◆ *Partitë politike* janë pjesa kryesore përbërëse e parlamenteve. Struktura organizative e shumicës së parlamenteve ndërtohet rreth tyre. Në shumicën e sistemeve politike, partitë politike janë përçuesit kryesorë ndërmjet vendimmarrësve dhe shoqërisë civile. Partitë politike kanë qëndrimet e tyre specifike për sektorin e sigurisë dhe përdorin legjislativën si forum për të nxjerrë mendimet e tyre para publikut.
- ◆ *Komisionet parlamentare* janë organet kryesore legjislative që ushtrojnë funksionin mbikëqyrës të parlamentit. Komisionet janë thelbësore sepse ato janë në gjendje të shqyrtojnë hollësisht punën dhe rezultatet e qeverisë. Struktura e komisioneve u jep parlamentarëve mundësinë që të organizojnë punën e tyre dhe të sjellin ekspertizën e tyre. Për më tepër, ato lejojnë komunikimin e drejtpërdrejtë ndërmjet parlamentarëve që u përkasin partive të ndryshme politike.⁶

Komisionet mund të ushtrojnë mbikëqyrje mbi sektorin e sigurisë brenda kornizës së mandatit të dedikuar, siç është komisioni për mbikëqyrjen e inteligjencës, ose brenda mandatit të gjerë, siç janë komisionet për buxhet dhe financa ose për të drejtat e njeriut. Duke pasur parasysh kompleksitetin e sektorit të sigurisë, është e nevojshme një strukturë e zhvilluar mirë e komisioneve, nëse pritet që parlamenti të ushtrojë ndikim të vërtetë mbi qeverinë. Në mënyrë të veçantë, komisionet parlamentare mund të luajnë rol vendimtar në monitorimin, hetimin dhe raportimin e abuzimeve nga sektori i sigurisë dhe brenda tij. Për shembull, funksioni kryesor i Komisionit Parlamentar Austriak për Forcat e Armatosura është mbledhja e ankesave dhe paraqitja e tyre në parlament në raportin e tij vjetor. Për të arritur konformitet, komisioni bën inspektime me paralajmërim në të gjithë vendin.⁷

Një komision mbikëqyrës efektiv ka tiparet e mëposhtme.

- Funksionimi dhe kompetencat e tij bazohen në rregulla procedurale.
- Ushtron kontroll mbi programet e punës së vet (rendin e ditës, çështjet, datat, frekuencat e mbledhjeve të komisionit) dhe ka lirinë e duhur për iniciimin dhe ndryshimin e legjislativës.

- Ka qasje në të gjitha informacionet që i çmon të nevojshme për kryerjen e mandatit të tij, përfshirë informacionin e klasifikuar që është me rëndësi thelbësore për mbikëqyrjen mbi sektorin e sigurisë.
- Mund të përdorë raportet e mendimit mospajtues.
- Ka koordinim të rregullt të ndërsjellë me komisionet e tjera të rëndësishme për sektorin e sigurisë, siç janë ato të mbrojtjes, punëve të brendshme, çështjeve buxhetore, të drejtave të njeriut dhe punëve të jashtme.
- Kryesohet nga një deputet me përvojë që ka njohuri të politikave të mbrojtjes dhe të sigurisë; është praktikë e mirë që kryesuesi të jetë nga një parti opozitare.
- Ka kompetencën të organizojë seanca dëgjimi për çdo temë që e çmon të nevojshme.
- Ka kompetencën të kërkojë që ministrat dhe ekspertët civilë dhe ushtarakë të japin dëshmi në seanca dëgjimi.
- Përdor në mënyrë efektive ekspertët nga academia dhe organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertët jashtë qeverisë.
- Ka dhomat e veta të mbledhjeve, stafin, buxhetin dhe dokumentacionin e vet.⁸

Komisionet parlamentare shtjellohen më tej në pjesën 5.2.

- ◆ *Institucionet parlamentare të ombudspersonit dhe IKDNj-të* janë mekanizma të zakonshëm për ushtrimin e disa aspekteve të funksionit mbikëqyrës të parlamentit. IKDNj-të janë organe të pavarura që themelohen me akt kushtetues ose legjislativ, të financuara nga shteti dhe që në mënyrë specifike kanë mandat mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut (njihen gjithashtu si komisione për të drejtat e njeriut ose komisione për mundësi të barabarta). Të gjitha IKDNj-të, falë fushëveprimit të tyre për të drejtat e njeriut, kanë për detyrë të mbrojnë dhe të promovojnë të drejtat e grave dhe barazinë gjinore. Në shumë vende themelohen IKDNj të specializuara për të adresuar diskriminimin, barazinë dhe/ose të drejtat e grave, si për shembull komisioni për mundësi të barabarta ose komisari për diskriminimin gjinor.
- ◆ *Institucionet e ombudspersonit janë* organe zyrtare të kryesuar nga ombudspersoni (që mund të ketë një titull tjetër, siç është “Mbrojtësi Publik” ose “Avokati i Popullit”). Shprehja “institucion i ombudspersonit” përfshin një gamë të gjerë të organizatave me mandate, kompetenca dhe funksione të ndryshme, të rregulluara me legjislacionin kombëtar. Ombudspersoni zakonisht emërohet nga qeveria ose parlamenti, por ka shkallë të konsiderueshme të pavarësisë. Institucionet e ombudspersonit kanë për detyrë të përfaqësojnë interesat e publikut duke hetuar dhe adresuar ankesat e keq-administrimit ose shkeljen e të drejtave. Në disa vende (si Gjermania, Holanda, Serbia, Spanja dhe Suedia), ombudspersoni në nivel kombëtar ka kompetenca të përgjithshme për të pranuar ankesa individuale, përfshirë ato kundër sektorit të sigurisë.⁹ Në disa vende janë krijuar institucione të ombudspersonit për të mbikëqyrur institucionet e sektorit të sigurisë, përfshirë policinë dhe forcat e armatosura, siç janë Ombudsmani i Policisë për Irlandën Veriore dhe Komisari Parlamentar për Forcat e Armatosura në Gjermani. Institucionet e tilla zakonisht shqyrtojnë dhe komentojnë projektligjet nga perspektiva e mbrojtjes së të drejtave të njeriut; monitorojnë implementimin e ligjeve dhe mbikëqyrin praktikën e organeve shtetërore, përfshirë institucionet e sektorit të sigurisë; trajtojnë ankesat individuale kundër organeve shtetërore; dhe monitorojnë kushtet dhe entet e mbajtjes në ndalim, veçanërisht në vendet ku institucionet e ombudspersonit janë përcaktuar si Mekanizëm Kombëtar Parandalues sipas Protokollit Fakultativ të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar. Bashkëpunimi parlamentar me institucionet e ombudspersonit dhe IKDNj-të shqyrtohen më tej në pjesën 5.4.
- ◆ *Stafi parlamentar* luan rol qendror në funksionimin e parlamenteve. Anëtarët e stafit paraqesin burim ekspertize nga e cila përfitojnë deputetë individualë dhe partitë politike. Stafi profesional që ka qasje në trajnime dhe resurse adekuate për qeverisje të mirë të sigurisë dhe/ose që ka grumbulluar përvojë të konsiderueshme duke mbështetur

proceset parlamentare, me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të sigurisë, formon rezervuar unik të njohurive, aftësive dhe kujtesës institucionale që mund të shfrytëzohet nga deputetët. Ata mund të sigurojnë vazhdimësi në diskutimet rreth çështjeve të ndërlukuara të sigurisë dhe të ofrojnë kontekstin historik. Së këndejmi, stafi paraqet element thelbësor në fuqizimin e deputetëve dhe komisioneve për të ofruar mbikëqyrje efektive mbi sektorin e sigurisë.

- ◆ *Shërbimet e kërimit parlamentar* ofrojnë analizë jopartiake dhe të ekuilibruar në lidhje me çështjet e sigurisë, të përshtatura enkas për të përmbushur nevojat e deputetëve.
- ◆ *Shoqëria civile* përbën partner qendror në mbështetjen që i ofrohet deputetëve në përpjekjet për të reformuar dhe mbikëqyrur sektorin e sigurisë. Angazhimi i shoqërisë civile është aspekt thelbësor i qeverisjes së mirë të sigurisë. Parlamentet mund të përdorin mjete të ndryshme për ndërveprim me shoqërinë civile, duke përfshirë bërjen e dialogut kombëtar, organizimin e konsultimeve publike, siç është mbajtja e dëgjimeve parlamentare për ligjet e propozuara dhe kërkitimi i prezantimeve nga ekspertët. Marrëdhëniet e tilla janë tradita të vendosura prej kohësh në shumë shoqëri dhe forcojnë legjitimitetin e parlamentit. Angazhimi parlamentar me shoqërinë civile shqyrtohet në pjesën 5.3.

Fusnotat

1. H. Born and G. Mesevage (2012) "Introducing intelligence oversight", in H. Born and A. Wills (eds) *Overseeing Intelligence Services: A Toolkit*, Geneva: DCAF, p. 7.
1. M. Bastick (2014) *Integrating a Gender Perspective into Oversight of the Security Sector by Ombuds Institutions & National Human Rights Institutions*, Geneva: DCAF, OSCE/ODIHR, OSCE, p. 5.
2. DCAF (2009) *Gender and Security Sector Reform*, Geneva: DCAF, p. 7.
3. CSCE (1995) "Budapest Document 1994: [Towards a genuine partnership in a new era](#)", Helsinki: Helsinki Monitor. OSBE ishte organizata e parë e sigurisë që ideoi dhe adoptoi një koncept të sigurisë gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunuese, që shtetet pjesëmarrëse e riafirmuan në dokumentet dhe vendimet madhore të nxjerra që nga Akti Përfundimtar i Helsinkit. Në thelb të konceptit të OSBE-së për siguri gjithëpërfshirëse qëndron kuptimi se dimensionet politiko-ushtarake, ekonomik-mjedisore dhe ato njerëzore janë të gjitha me rëndësi të barabartë për sigurinë.
4. H. Born, P. Fluri and S. Lunn (2010) "Oversight and guidance", in H. Born, P. Fluri and S. Lunn (eds) *The Relevance of Parliamentary Oversight for the Security Sector*, Geneva: DCAF, p. 6; DCAF (2015) "Parliaments", SSR Backgrounder Series, Geneva: DCAF, p. 2.
5. W.F. van Eekelen (2010) "The democratic control of the armed forces: The national and international parliamentary dimension", in H. Born, P. Fluri and S. Lunn (eds) *The Relevance of Parliamentary Oversight for the Security Sector*, Geneva: DCAF, p. 47.
6. Intervistë me deputetin Michael Hammer, Drejtor Ekzekutiv i Komisionit Parlamentar Austriak për Forcat e Armatosura Federale, Austri, 9 tetor 2018; intervistë me Otto Pendl, Drejtor i Komisionit Parlamentar Austriak për Forcat e Armatosura Federale, Austri, 13 tetor 2018.
7. H. Born (2010) "Learning from best practices of parliamentary oversight of the security sector", in H. Born, P. Fluri and S. Lunn (eds) *The Relevance of Parliamentary Oversight for the Security Sector*, Geneva: DCAF, p. 33.
8. M. Bentinck and H. Born (2013) *Parliamentary Oversight of the Security Sector*, Brussels: European Parliament Office for Promotion of Parliamentary Democracy, p. 29.



3. Pse është më rëndësi barazia gjinore dhe integrimi i perspektivës gjinore në mbikëqyrjen parlamentare mbi sektorin e sigurisë?

Barazia gjinore duhet të jetë në thelb të vendimmarrjes parlamentare. Një parlament me ndjeshmëri gjinore i përgjigjet nevojave dhe interesave të burrave dhe të grave në përbërjen, strukturat, operacionet, metodat dhe punën e tij. Legjitimiteti i tij buron nga përfaqësimi i zërave të zgjedhësve në të gjithë diversitetin e tyre dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse. Në fund të fundit, është një parlament që është më efikas dhe më efektiv.*

Parlamentet mund dhe do të duhej të kontribuojnë në qeverisjen e mirë të sektorit të sigurisë: duke i bërë institucionet e sektorit të sigurisë më transparente, më llogaridhënëse, në konformitet me të drejtat e njeriut dhe me ndjeshmëri gjinore, dhe që funksionojnë mbi bazën e sundimit të ligjit. Barazia gjinore është pjesë integrale e qeverisjes së mirë të sektorit të sigurisë sepse kjo barazi është e drejtë themelore e njeriut dhe parim demokratik; është thelbësore për sundimin e ligjit. (Shih Kornizat 2 dhe 4 për përkufizimet e shprehjeve kryesore gjinore të përdorura në këtë Modul.)[^]

Korniza 2: Gjinia dhe Barazia Gjinore

Gjinia i referohet roleve, sjelljeve, aktiviteteve dhetributeve që shoqëria e caktuar në një kohë të caktuar i konsideron të përshtatshme bazuar në seksin biologjik. Ajo gjithashtu i referohet marrëdhënieve ndërmjet grave dhe burrave dhe vajzave dhe djemve, si dhe marrëdhënieve ndërmjet grave dhe atyre ndërmjet burrave. Këtotribute, mundësi dhe marrëdhënie janë *konstrukte shoqërore* dhe *mësohen* përmes proceseve të shoqërimin. Ato janë specifike për nga konteksti dhe koha dhe ndryshojnë. Gjinia përcakton atë që pritët, lejohet dhe vlerësohet te një grua ose burrë në kontekstin e caktuar. Në shumicën e shoqërive ka dallime dhe pabarazi midis grave dhe burrave në përgjegjësitë e caktuara, aktivitetet e ndërmarra, qasjen dhe kontrollin mbi resurset dhe mundësitë e vendimmarrjes.

Barazia gjinore është e drejtë themelore e njeriut dhe synim për të cilin janë zotuar qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare. Barazia gjinore do të thotë që “të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e individëve nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur mashkull ose femër” (UN OSAGI, 2001). Në kontekstin e sektorit të sigurisë, kjo do të thotë që gratë dhe burrat kanë mundësi të barabarta për të marrë pjesë në ofrimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e sigurisë, dhe se nevojat e sigurisë të grave, burrave, vajzave dhe djemve përmbushen në mënyrë të barabartë.

Burimi: UN OSAGI (2001) Important Concepts Underlying Gender Mainstreaming, New York: United Nations.

Ndjekja e barazisë gjinore dhe integrimi i perspektivës gjinore ndihmojnë për të ofruar siguri efektive. Ofrimi i sigurisë njuh dhe adreson nevojat e ndryshme të sigurisë për të gjitha pjesët e komuniteteve, përfshirë gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, dhe personat lezbike, gej, biseksualë, trans dhe interseks (LGBTI).

* Unioni Ndër-Parlamentar, Instituti Evropian për Barazi Gjinore dhe OSCE/ODIHR kanë publikuar module për parlamentet me ndjeshmëri gjinore, të listuara në pjesën 7.

[^] Gjinia, rolet gjinore, stereotipat gjinorë, maskuliniteti dhe feminiteti, barazia gjinore, interseksionaliteti dhe diversiteti i orientimit seksual dhe i identitetit dhe shprehjes gjinore shqyrtohen më hollësisht në Modulin 1, “Qeverisja e Sektorit të Sigurisë, Reformat në Sektorin e Sigurisë dhe Çështjet Gjinore”.

Foto: Gratë egjiptiane rreshtohen për të votuar në zgjedhjet parlamentare, 2011 © UN Women/Fatma Elzahraa Yassin.

Për të adresuar paragjykimin gjinor, për të parandaluar diskriminimin dhe për të përvetësuar qasje gjithëpërfshirëse gjinore ndaj sigurisë, është e rëndësishme të kuptohet *interseksionaliteti* - d.m.th., si ndërveprojnë identitetet dhe pritjet gjinore me identifikuesit e tjerë shoqërorë, siç janë përkatësia etnike, raca, prejardhja fetare, mosha, klasa sociale, orientimi seksual, statusi martesor, aftësia e kufizuar dhe situata e njerëzve në pozita të ndryshme të pushtetit dhe privilegjit, diskriminimit dhe përjashtimit. Interseksionaliteti gjendet “kur personi identifikon se i përket më shumë se një grupi të marginalizuar, [gjë] që e përkeqëson nivelin e cenueshmërisë së përjetuar”.¹ Është e nevojshme që çdo punë rreth çështjeve gjinore dhe sigurisë të marrë në konsideratë se si gjinia kryqëzohet me prejardhjen etnike-fetare, moshën, klasën shoqërore, orientimin seksual, statusin martesor, racën, përkatësinë etnike, aftësinë e kufizuar dhe identifikuesit tjerë demografikë, në vende të ndryshme dhe në periudha të ndryshme.*

Institucionet efektive dhe efikase të sektorit të sigurisë janë përfaqësuese të diversitetit të popullsisë të cilës i shërbejnë, përfshirë (megjithëse jo vetëm) gratë, burrat dhe personat LGBTI.

Mbikëqyrja parlamentare luan role kyçe në arritjen e barazisë gjinore brenda sektorit të sigurisë për disa arsye.

- ◆ Nëse institucionet e sigurisë priten të funksionojnë brenda kornizës së barazisë gjinore, krijimi i kornizës së përshtatshme ligjore dhe politike ka rëndësi thelbësore.
- ◆ Legjislacioni i drejtë dhe efektiv duhet të marrë parasysh nevojat e sigurisë dhe qasjen në siguri për grupet e ndryshme të individëve: gratë, burrat, vajzat dhe djemtë kanë përvoja të ndryshme të sigurisë.
- ◆ Është e nevojshme analiza gjinore e ligjeve dhe politikave kombëtare dhe ndikimit të tyre në ofrimin e shërbimeve publike, për të siguruar praktika që përputhen me nevojat e spektrit të plotë të shoqërisë.

Kjo pjesë hulumton më hollësisht katër arsyet kryesore pse promovimi i barazisë gjinore dhe integrimi i perspektivës gjinore kanë rëndësi kritike për mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë:

- ◆ për të mbështetur dhe respektuar standardet ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut
- ◆ për të siguruar që ligjet dhe rregulloret lidhur me sigurinë dhe drejtësinë janë gjithëpërfshirëse dhe adresojnë diversitetin e nevojave
- ◆ për të arritur buxhetimin korrekt gjinor për sektorin e sigurisë
- ◆ për të siguruar që vetë mbikëqyrja parlamentare ka diversitet dhe është gjithëpërfshirëse.

3.1 Përmbushja e standardeve ligjore dhe normative ndërkombëtare dhe rajonale për barazinë gjinore

Mbikëqyrja e parlamenteve mbi sektorin e sigurisë duhet të udhëhiqet dhe të përforcojë normat dhe standardet ndërkombëtare që lidhen me të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe sundimin e ligjit, siç janë ato të mishëruara në Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW - shih Korniza 3) dhe të zhvilluara nëpërmjet Agjendës Gratë, Paqja dhe Siguria (shih Korniza 7 në faqen 23).

Që nga Konferenca e Katërt Botërore e OKB-së për Gratë në Pekin në 1995, *njësimi i çështjeve gjinore* - procesi për të siguruar që politikat dhe praktikat plotësojnë nevojat e burrave dhe grave në mënyrë të barabartë - është përshëndetur si strategji kryesore për arritjen e barazisë gjinore.² Njësimi i çështjeve gjinore mund të ndihmojë në adresimin e nevojave të të gjitha grave, burrave, djemve dhe vajzave, si dhe njerëzve me prejardhje të larmishme, përfshirë identitetet e ndryshme gjinore, moshën, aftësinë e kufizuar, etj. Për më tepër, mund të ndihmojë

* Gjinia, rolet gjinore, stereotipat gjinorë, maskuliniteti dhe feminiteti, barazia gjinore, interseksionaliteti dhe diversiteti i orientimit seksual dhe i identitetit dhe shprehjes gjinore diskutohen më hollësisht në Modulin 1, “Qeverisja e Sektorit të Sigurisë, Reformat në Sektorin e Sigurisë dhe Çështjet Gjinore”.

Kryerja e analizës gjinore interseksionale shqyrtohet në Modulin 15, “Integrimi i Çështjeve Gjinore në Hartimin dhe Monitorimin e Projekteve për Sektorin e Sigurisë dhe Drejtësisë”.

në identifikimin e fushave ku veprimi afirmativ (diskriminimi pozitiv) ose masa të tjera mund ta bëjnë të mundur korrigjimin e ndikimit të vazhdueshëm të diskriminimit historik dhe të ditëve të sotme bazuar në gjini.

Korniza 3: Instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe sigurinë

Një varg detyrimesh ligjore kombëtare, rajonale dhe globale janë relevante për perspektivën gjinore dhe/ose detyrojnë shtetet të integrojnë perspektivën gjinore në punën e sektorit të sigurisë. Një përmbledhje e instrumenteve ligjore ndërkombëtare dhe rajonale është botuar në internet si pjesë e kësaj Pakete të Moduleve.

Instrumentet kryesore përfshijnë si më poshtë.

- + CEDAW dhe Rekomandimet e Përgjithshme të Komitetit CEDAW.
- + Parimet Yogyakarta dhe Parimet Yogyakarta Plus 10 që kanë të bëjnë me të drejtat e personave me orientime seksuale dhe identitete dhe shprehje gjinore të ndryshme.
- + Traktatet rajonale për të drejtat e njeriut, si Protokollit Maputo i Unionit Afrikan dhe Konventa e Stambollit e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.
- + OZhQ OKB: OZhQ 5 (arritja e barazisë gjinore) dhe 16 (promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse) kanë rëndësi të veçantë për sektorin e sigurisë dhe drejtësisë, por OZhQ 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8, 10, 11 dhe 13 janë relevante gjithashtu.
- + Kornizat institucionale rajonale, siç është Plani i Veprimit i OSBE-së i vitit 2004 për Promovimin e Barazisë Gjinore dhe Vendimi nr. 7/09 i vitit 2009 i Këshillit Ministror mbi pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe publike.

Ky Modul përdor konceptin e ngjashëm por më gjithëpërfshirës të “integritit të perspektivës gjinore”. *Perspektiva gjinore* është një mënyrë për të vështruar apo analizuar që shqyrton ndikimin që ka gjinia në mundësitë, rolet shoqërore dhe ndërveprimet e njerëzve. Kjo mënyrë e vështrimit është ajo që ia bën të mundur individit të kryejë analiza gjinore dhe më pas të njësijë çështjet gjinore në çdo program, politikë ose organizatë të propozuar.³ Integrimi i perspektivës gjinore do të duhej të ndodhë krahas masave të krijuara në mënyrë aktive për të promovuar barazinë gjinore.

3.2 Sigurimi i inkluzivitetit dhe gjithëpërfshirjes lidhur me nevojat e ndryshme të ligjeve dhe normave që kanë të bëjnë me sigurinë

Fuqia themelore e parlamenteve qëndron te ligjvënja, që është e ndërvarur nga proceset e mbikëqyrjes. Parlamentet krijojnë kornizat ligjore që mund të mbështesin dhe avancojnë barazinë gjinore dhe hedhin bazat për politikën dhe buxhetimin përkatës, përfshirë personelin, shërbimet dhe standardet e sektorit të sigurisë.

Gratë gjithnjë e më shumë po rekrutohen dhe përparojnë brenda institucioneve të sektorit të sigurisë.* Këto përpjekje bazohen në arsyeshmërinë e mëposhtme: zotimi për mundësi të barabarta punësimi për burrat dhe gratë; që institucionet e balancuara gjinore të sektorit të sigurisë rritin legjitimitetin e perceptuar të sektorit të sigurisë dhe besimin në sektorin e sigurisë; dhe që gratë mishërojnë aftësi dhe pika të forta të ndryshme që janë të dobishme.⁴ Parlamentet mund të luajnë role kyçe në drejtimin dhe mbështetjen e institucioneve të sektorit të sigurisë për të përfshirë më shumë gra dhe për t'u bërë më përfaqësues i shoqërisë në përgjithësi, për shembull, duke reformuar dispozitat ligjore që bllokojnë gratë nga role të caktuara (siç janë rolet e ngushta luftarake brenda ushtrisë), duke hartuar legjislacion dhe ndryshime që kanë për qëllim promovimin e barazisë gjinore brenda institucioneve dhe duke vënë nën thjerrëz ndikimin e ligjeve dhe rregulloreve mbi gratë dhe burrat.

* Shih diskutimin dhe të dhënat në Modulet 2, 3 dhe 14.

Gjinia e personit - ashtu si edhe mosha, aftësia e kufizuar, përkatësia etnike, identiteti seksual dhe klasa - është e lidhur ngushtë me mënyrën se si ai ose ajo e përjeton dhunën, preket nga dhuna dhe merr pjesë në dhunë. Për më tepër, gjinia e personit - së bashku me tiparet e tjera - është e lidhur ngushtë me mënyrën se si ai ose ajo e përjeton sigurinë dhe është i përfshirë në ofrimin e sigurisë.

Gratë, burrat, djemtë dhe vajzat kanë nevojë të ndryshme të sigurisë, të cilat do të duhej të reflektohen në të drejtën penale dhe legjislacionin në lidhje me sigurinë dhe drejtësinë. Ndërsa gratë dhe vajzat janë shumica dërrmuese e viktimave të DhBGj, burrat dhe djemtë gjithashtu mund të jenë viktimë, jo vetëm gjatë konfliktit, por edhe në kohë paqesje.* Është thelbësore që ligjet që përkufizojnë përdhunimin dhe veprat e tjera kundër integritetit seksual të jenë të ndjeshme ndaj aspektit gjinor. Parlamentet kanë kompetenca për të kërkuar llogari nga institucionet dhe personeli i sigurisë për parandalimin dhe përgjigjen efektive ndaj DhBGj që prek gratë, vajzat, burrat dhe djemtë.

Personat LGBTI dhe të tjerët me orientime seksuale dhe me identitete dhe shprehje gjinore të ndryshme (shih Korniza 4) shpesh përballen me forma të veçanta të diskriminimit, shfrytëzimit, abuzimit dhe dhunës. Kjo njihet nga shumë shtete dhe organizata ndërkombëtare që adresojnë diskriminimin në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor në ligjet dhe deklaratat e tyre.⁵ Diskriminimi, shfrytëzimi, abuzimi dhe dhuna ndaj personave LGBTI përfshijnë (por jo vetëm) cytjen dhe bullizmin për mosrespektim të normave gjinore, poshtërimin, zhvatjen dhe shantazhin, ngacmimin dhe shfrytëzimin seksual, si dhe format e ndryshme të dhunës fizike dhe seksuale, që nganjëherë çojnë në vdekje. Në vendet ku homoseksualizmi është i kriminalizuar, personat LGBTI të cilët janë viktimë të krimit mund të ngurrojnë që të kërkojnë drejtësi.⁶ Parlamentet duhet ta kenë synim themelor mbrojtjen e të drejtave të të gjithë zgjedhësve, pavarësisht nga orientimi i tyre seksual, identiteti dhe shprehja gjinore.

Korniza 4: Diversiteti i orientimeve seksuale dhe i identiteteve dhe shprehjeve gjinore

Moduli 1 shpjegon më hollësisht se çka nënkupton diversiteti i orientimeve seksuale dhe i identiteteve dhe shprehjeve gjinore. Kjo frazë gjithëpërfshirëse njihet personat që identifikohen si LGBTI, por edhe personat orientimet seksuale të të cilëve nuk janë (ose nuk janë vetëm) në radhë të parë heteroseksuale dhe identitetet gjinore të të cilëve jo medoemos i nënshtrohen aspektit gjinor binar burrë/grua. Kjo përfshin identitetet gjinore jo-binare jo-perëndimore.

Ndërsa ky Modul përdor shpesh shprehjet “burrë” dhe “grua”, është e rëndësishme të mbani mend që disa njerëz nuk identifikohen me asnjërën ose ekskluzivisht si burrë ose grua. Diskriminimi dhe dhuna me të cilën përballen njerëzit me orientime seksuale dhe me identitete dhe shprehje gjinore të ndryshme, janë të lidhura ngushtë me rolet gjinore.

3.3 Arritja e buxhetimit të drejtë gjinor për sektorin e sigurisë

Parlamentet janë në gjendje të formojnë buxhete të përgjegjshme gjinore në lidhje me sigurinë që marrin parasysh nevojat e ndryshme gjinore të të gjithë zgjedhësve. Për ta bërë këtë, parlamentet duhet të jenë të vetëdijshme për prerogativat e tyre të mbikëqyrjes buxhetore (shih Korniza 5) dhe të jenë të gatshme t'i ushtrojnë ato. Në shumë vende, për shkak të pranimit të gjerë të nocionit se fushat e sigurisë dhe mbrojtjes bien kryesisht brenda ekzekutivit, parlamentet ia kanë dorëzuar ekzekutivit kompetencat e tyre të iniciativës në këto çështje. Në krahasim me sektorët e tjerë, siç është bujqësia dhe arsimiti, shqyrtimi i hollësishëm i buxheteve të sigurisë dhe mbrojtjes përbën sfidë shtesë për shkak të natyrës së ndjeshme të buxheteve të caktuara (p.sh. inteligjenca) dhe tendencës së qeverive për të mbi-klasifikuar informacionin.⁷ Buxhetet e sigurisë të paraqitura në parlament nuk mund të jenë aq të hollësishme ose zë për zë, gjë që e bën më të vështirë për deputetët të identifikojnë fushat me risk potencial për korrupsion ose të kryejnë analizë gjinore.

* Për qëllimin e kësaj Pakete të Moduleve, shprehja “dhuna në bazë gjinore” (DhBGj) është përdorur për t’u referuar të gjitha veprimeve të dëmshme që i shkaktohen dikujt për shkak të supozimeve normative për gjininë e tyre. DhBGj është shprehje ombrellë për çdo veprim të dëmshëm që kryhet pa vullnetin e personit dhe bazohet në dallimet e caktuara shoqërore (gjinore) midis femrave dhe meshkujve. Natyra dhe shtrirja e llojeve specifike të DhBGj ndryshojnë midis kulturave, vendeve dhe rajoneve. Si shembuj të saj përfshihen dhuna seksuale, shfrytëzimi/abuzimi seksual dhe trafikimi për shfrytëzim seksual; dhuna në familje; martesë e detyruar/e hershme; praktikat e dëmshme tradicionale siç është gjymtimi i organeve gjenitale femërore; vrasjet e nderit; trashëgimia e të vejave dhe dhuna homofobike dhe transfobike.

Shih UN Women (2019) “Gender equality glossary”, <https://trainingcentre.unwomen.org/mod/glossary/view.php?id=36> (qasur më 6 shtator 2019); OHCHR (2011) “Discriminatory laws and practices and acts of violence against individuals based on their sexual orientation and gender identity”, report of the UN High Commissioner for Human Rights, UN Doc. A/HRC/19/41, 17 November, para. 20..

Sidoqoftë, parlamenti “kontrollon kuletën” dhe ka për detyrë të garantojë që nevojat e sigurisë të grave, burrave, djemve dhe vajzave merren parasysh në mënyrë të barabartë. Duke njohur sfidën e mbikëqyrjes së buxheteve të sektorit të sigurisë, parlamentet në të gjithë botën po kërkojnë mënyra për kontroll të rritur parlamentar të buxheteve të sigurisë. Në Gjermani, Komisioni Parlamentar i Buxhetit themeloi një nën-komision, të quajtur Grupi i Mirëbesimit, i cili ka për detyrë ekskluzivisht mbikëqyrjen e buxheteve të agjencive të inteligjencës. Anëtarët e Grupit të Mirëbesimit kanë qasje të gjerë në informacionin e klasifikuar dhe bashkëpunojnë me komisionin e mbikëqyrjes së inteligjencës për të siguruar mbikëqyrje më efektive.⁸

Korniza 5: Llojet e kompetencave buxhetore parlamentare

Në kuptim të kompetencave të tyre përkatëse buxhetore, mund të identifikohen tri kategori të gjera të legjislativave:

- ✦ Legjislativat për bërjen e buxhetit, siç është Kongresi amerikan, që mund të ndryshojnë, refuzojnë dhe madje të formulojnë propozime alternative buxhetore. Legjislatura është tejet e përfshirë në buxhetimin për sektorin e sigurisë, politika dhe mbikëqyrje, dhe në përputhje me rrethanat ka staf me ekspertizën e nevojshme.
- ✦ Legjislativat me ndikim në buxhet, si shumica e parlamenteve në Evropë, mund të ndryshojnë dhe të refuzojnë projektligjet, por nuk mund paraqesin propozimet e veta. Kjo nuk i pengon ato nga ekzaminimi i hollësishëm i buxheteve të propozuara dhe përgatitja e ndryshimeve të shumta, siç mund të vërehet në Gjermani dhe në Holandë, për shembull.
- ✦ Legjislativat e bazuara në sistemin britanik Westminster (ku përfshihen Australia, Kanadaja, India, Zelanda e Re, Afrika e Jugut, Mbretëria e Bashkuar dhe Zambia) janë të autorizuar vetëm për të reduktuar zërat ekzistues buxhetorë, por jo për t'i rritur ose për të shtuar zëra tjerë.

Duke marrë parasysh implikimet e secilit model për mbikëqyrjen e përgjegjshme gjinore, legjislativat për bërjen e buxhetit kanë tendencë të jenë më efektive: ato jo vetëm që mund të modifikojnë propozimet ekzistuese buxhetore, por kanë edhe mundësinë e paraqitjes së propozimit alternativ.

Burimi: M. Bentinck and H. Born (2013) Parliamentary Oversight of the Security Sector, Brussels: European Parliament Office for Promotion of Parliamentary Democracy, p. 28.

3.4 Kujdesi që vetë mbikëqyrja parlamentare ka diversitet dhe është gjithëpërfshirës

Parlamentet moderne është e pritshme që të jenë institucione përfaqësuese, transparente, të arritshme, llogaridhënëse dhe efektive, dhe vende ku pikëpamjet e një game të gjerë të hisedarëve jo vetëm që janë të mirëpritura, por konsiderohen thelbësore. Pjesë e kësaj pritshmërie është se do të duhej të ketë ekuilibër gjinor: në rastin ideal, pjesëmarrje të barabartë të burrave dhe grave në parlament. Kjo ka të bëjë jo vetëm me vendimmarrjen e informuar mirë, por edhe me përfaqësimin demokratik dhe legjitimitetin, dhe kërkohet sipas kornizave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (përfshirë ato të listuara në Kornizën 3).

Sidoqoftë, parlamentet duhet të aspirojnë për të arritur jo vetëm ekuilibër të barabartë të grave dhe burrave, por edhe *diversitet* të burrave dhe grave, nga lloje të ndryshme të prejardhjes dhe me tipare të ndryshme. Kur parlamentarët vijnë nga një gamë e gjerë prejardhesh (p.sh. socio-ekonomike, klasore, fetare dhe etnike) dhe kanë tipare të larmishme (p.sh. mosha, gjinia dhe orientimi seksual), ata reflektojnë dhe përfaqësojnë më mirë diversitetin e shoqërisë të cilës i shërbejnë. Gjithashtu, do të duhej të ketë diversitet në distribuimin e roleve parlamentare dhe përgjegjësi për vendimmarrje brenda parlamentit, veçanërisht në pozitat kryesore.

Krahas diversitetit, parlamenti do të duhej të jetë gjithëpërfshirës, llogaridhënës dhe transparent. Kjo nënkupton një parlament që shtrin veprimtarinë përgjatë mbarë shoqërisë për të dëgjuar, për t'u këshilluar dhe për t'u përgjigjur, si dhe për të shkëmbyer informacione me publikun. Parlamenti gjithëpërfshirës është më i informuar në lidhje me nevojat e veçanta të sigurisë për të gjithë njerëzit brenda shoqërisë, dhe kur parlamentet janë gjithëpërfshirëse, forcohet legjitimiteti i mbikëqyrjes së tyre.⁹

Gratë mbeten tejet të nën-përfaqësuar në parlamentet kombëtare. Të dhënat e përpiluara nga Unioni Ndërlamentar dëshmojnë se, në prill 2019, qëndronte gjendja e mëposhtme.¹⁰

- ◆ Vetëm 24.3 për qind e parlamentarëve të botës ishin gra, dhe vetëm 46 vende kishin kapërcyer pragun prej 30 për qind në përfaqësimin e grave.*
- ◆ Analiza rajonale zbulon se parlamentet në vendet nordike kishin 42.5 për qind gra deputete, pasuar nga Amerika e Veriut dhe Amerika e Jugut me 30.6 për qind. Rajoni i Paqësorit kishte përqindjen më të ulët të grave me 16.3 për qind.
- ◆ Në radhët e Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, përqindja mesatare e grave në parlament ishte 26.7 për qind (shih Tabela 1).

Tabela 1: Gratë në parlament në vendet e OSBE-së, mesatarja rajonale

Kategoria	Një Dhomë ose Dhoma e Ulët (%)	Dhoma e Lartë ose Senati (%)	Të dy Dhomat së bashku (%)
Evropë - Shtetet pjesëmarrëse në OSBE, përfshirë vendet nordike	28.6	28.1	28.5
Evropë - Shtetet pjesëmarrëse në OSBE, pa përfshirë vendet nordike	27.2	28.1	27.4

Burimi: Inter-Parliamentary Union (2019) "Women in national parliaments: Regional averages (situation as of 1 April 2019)", <http://archive.ipu.org/wmn-e/arc/world010419.htm>.

Ndër dhjetë vendet e para sa i përket pjesëmarrjes së grave, radhiten gjashtë vende nga Amerika Latine dhe Karaibet: Kuba, Bolivia, Meksika, Grenada, Nikaragua dhe Kosta Rika ose kanë arritur barazinë gjinore ose i janë afuar asaj.

Po shënohet progres. Në vitin 2007 gratë përbënin vetëm 17 për qind të parlamentarëve në të gjithë botën, me vetëm 18 vende që kishin arritur ose kapërcyer 30 për qind për përfaqësim të femrave.¹¹

Brenda parlamenteve, distribuimi i anëtarësisë/udhëheqjes së komisioneve gjithashtu ka tendencë gjinore; në fushën e shëndetësisë dhe arsimit ka më shumë gra parlamentare sesa që gjenden në komisionet e mbrojtjes, buxhetit dhe punëve të jashtme, të cilat zakonisht udhëhiqen nga burrat. Është domethënëse që përparimet e bëra gjatë dekadës së kaluar, në disa kontekste janë përkthyer në komisione parlamentare të balancuara për nga gjinia.


Parlamentarët, qofshin meshkuj apo femra, ndajnë përgjegjësinë për të siguruar që mbikëqyrja parlamentare reflekton sa më mirë popullatën në përgjithësi. Arritja e barazisë gjinore duhet të jetë synim për parlamentin në vetvete. Një parlament gjithëpërfshirës me më shumë diversitet përbën organ më efektiv për të siguruar që të gjitha funksionet e tij mbikëqyrëse integrojnë perspektivën gjinore.

* Të dhënat për gratë në parlamentet kombëtare publikohen nga Unioni Ndërlamentar, <https://data.ipu.org/>.

Fusnotat

1. OSCE Parliamentary Assembly (2018) "Gender balance report: Taking urgent action in the OSCE region to end gender-based violence", Berlin: OSCE, p. 10.
2. ECOSOC (1997) "Agreed conclusions 1997/2", <http://www.un.org/womenwatch/osagi/pdf/ECOSOCAC1997.2.PDF>.
3. UN Women (2019) "Gender equality glossary", <https://trainingcentre.unwomen.org/mod/glossary/view.php?id=36> (qasur më 29 janar 2019).
4. Inter-Parliamentary Union (2011) Gender-Sensitive Parliaments: A Global Review of Good Practice, Geneva: IPU.
5. Për shembull, rezolutat e Këshillit për të Drejtat e Njeriut dhe Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, <https://www.ohchr.org/EN/Issues/Discrimination/Pages/LGBTUNResolutions.aspx> (qasur më 26 mars 2019); Deklarata e Otavës e vitit 1995 e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së i bëri thirrje Shteteve pjesëmarrëse "të sigurojnë që të gjithë personat që u përkasin segmenteve të ndryshme të popullsisë së tyre trajtohen me respekt dhe konsideratë të barabartë në kushtetutat, legjisllacionin dhe administratën e tyre dhe se nuk ka nënshtrim, eksplicit ose të nënkuptuar në bazë të ... orientimit seksual"; European Union (2013) "Guidelines to promote and protect the enjoyment of all human rights by lesbian, gay, bisexual, transgender and intersex (LGBTI) persons".
6. Për shembull, në Liban, ndërsa homoseksualizmi nuk është shprehimisht i jashtëligjshëm, ka elemente të Kodit Penal që e kriminalizojnë aktin seksual ndërmjet personave të të njëjtit seks. Kjo i frenon personat LGBTI nga raportimi i përdhunimeve për shkak të frikës nga ndjekja penale dhe burgosja. L. Khattab and H. Myrntinen (2014) "Gender, security and SSR in Lebanon", Beirut: International Alert.
7. S. Lunn (2010) "The democratic control of armed forces in principle and practice", in H. Born, P. Fluri and S. Lunn (eds) The Relevance of Parliamentary Oversight for the Security Sector, Geneva: DCAF, p. 24.
8. EU Agency for Fundamental Rights (2017) Surveillance by Intelligence Services: Fundamental Rights, Safeguards and Remedies in the EU. Volume II: Field Perspectives and Legal Update, Luxembourg: Publications Office of the European Union, p. 65.
9. IPU and UNDP (2017) "Global parliamentary report 2017 – Parliamentary oversight: Parliament's power to hold government to account", Tignieu-Jameyzieu: Courand et Associés, p. 15.
10. IPU (2019) "Women in national parliaments", 1 April, <https://data.ipu.org/women-ranking?month=4&year=2019>.
11. IPU (2007) "Women in national parliaments", 30 April, <http://archive.ipu.org/wmn-e/arc/world300407.htm>.





4. Si do të dukej mbikëqyrja parlamentare e sektorit të sigurisë që avancojnë barazinë gjinore dhe integron perspektivën gjinore?

Kjo pjesë paraqet një vizion të asaj se çka kërkon përqendrimi në barazinë gjinore në funksionin e mbikëqyrjes parlamentare dhe shqyrton tiparet kryesore që promovojnë sigurinë duke integruar perspektivën gjinore.

Fushat kryesore që shqyrtohen janë përkufizimi i sigurisë dhe nevojave për siguri në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke marrë parasysh perspektivën gjinore; legjislacioni dhe strukturat efektive për të adresuar DhBGj-në; njësimi i çështjeve gjinore në buxhetim; dhe PKV-të për Agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria. Kjo pjesë paraqet shembuj nga Afrika, Amerika Qendrore, Makaronezia, Amerika Veriore dhe Evropa Juglindore.

Pjesa 5 shqyrton si parlamentarët mund ta arrijnë këtë vizion.

4.1 Siguria dhe nevojat e sigurisë janë të përkufizuara në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe me perspektivë gjinore

Parlamentet që janë efektive në funksionin e tyre mbikëqyrës krijojnë vizion për siguri gjithëpërfshirëse kombëtare. Në ndjekjen e këtij synimi, parlamentet mbështetin RSS-të “duke thelluar pronësinë kombëtare; duke zhvilluar vizionin për sigurinë, duke formuar korniza të shëndosha ligjore; duke siguruar menaxhim më të mirë të financave publike; duke inkurajuar kulturën e shërbimit; dhe duke ofruar qasje më gjithëpërfshirëse dhe më të përgjegjshme”.¹ Grave, burrave dhe individëve me prejardhje, orientim seksual, identitete dhe shprehje gjinore të ndryshme u garantohet qasje e barabartë në shërbimet e sigurisë dhe mekanizmat e llogaridhënies. Pa këtë, sektori i sigurisë rrezikon të përforcojë pabarazitë ekzistuese gjinore duke lejuar që anëtarët më të pushtetshëm të shoqërisë (përfshirë stafin e vetë institucioneve të sigurisë) të mbizotërojnë të tjerët.

Seancat e dëgjimit publik mund t'i ndihmojnë parlamentet që të vlerësojnë dhe dokumentojnë nevojën për evolucion ligjor. Një shembull nga Togo shquan se si mund të mbështeten proceset legjislative nëpërmjet konsultimeve publike mbi dhunën ndaj grave dhe vajzave. Në vitin 2010, parlamentarët femra në Togo organizuan konsultime kombëtare mbi dhunën ndaj grave dhe vajzave, me mbështetje nga partnerë ndërkombëtarë, përfshirë Unionin Ndërparlamentar. Duke përdorur pozitën e tyre drejtuese brenda parlamentit, gratë që mbanin pozitën e Nënkryetares së Parlamentit dhe Kryesueses së Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, mobilizuan mbështetjen nga partnerët ndërkombëtarë dhe hisedarët kombëtarë brenda dhe jashtë Asamblesë Kombëtare, që është organi legjislativ në Togo. Rezultatet e këtij procesi, që mbuloi çdo rajon dhe krahinë në vend, informuan zhvillimin e legjislacionit të propozuar për dhunën ndaj grave dhe vajzave, i pari i këtij lloji në Togo. Për zhvillimin e përmbajtjes së ligjit të propozuar, u krijua një ekip redaktues gjithëpërfshirës, duke përfshirë aktivistë për të drejtat e grave, specialistë të pavarur për çështjet gjinore dhe ligjore, këshilltarë teknikë nga Ministria për Promovimin e Grave dhe një grup bërthamë

Foto: Deputetët e Parlamentit Evropian vizitojnë Turqinë për të vlerësuar përgjigjen ndaj krizës së refugjatëve sirianë, 2016 © European Union 2016 - European Parliament.

i deputetëve meshkuj dhe femra nga parti të ndryshme politike. Versioni përfundimtar u shqyrtua nga ekipi redaktues gjatë një procesi punues njëjavor, përpara se të paraqitej në Asamblesë Kombëtare. Megjithatë ligji nuk ishte adoptuar ende në kohën e shkrimit të këtij Moduli, ky proces ka shërbyer për të vendosur çështjen e dhunës ndaj grave dhe vajzave në agjendën e Asamblesë Kombëtare dhe për t'u dhënë hisedarëve tjerë një pikë hyrëse për të avokuar për përmirësime ligjore.²

Parlamenti i El Salvadorit jep një shembull tjetër se si mund të përkufizohet siguria dhe nevojat e sigurisë në mënyrë gjithëpërfshirëse. Në vitin 2015, Parlamenti i El Salvadorit miratoi një ligj që merr parasysh sfidat unike të sigurisë me të cilat përballet komuniteti LGBTI. Një dialog midis deputetëve dhe komunitetit LGBTI çoi në përfundimin se sanksionet për krimet e motivuara nga urrejtja në bazë të orientimit seksual dhe identitetin gjinor duhej të bëheshin më të ashpra. Dhuna ndaj komunitetit LGBTI dhe mosndëshkimi për sulme të kryera nga aktorë jo-shtetërorë, veçanërisht bandat, janë probleme serioze. Sistemi i drejtësisë në El Salvador:

... ka dështuar të njohë dhe të hetojë krimet e urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI, duke i bërë kështu individët të cenueshëm nga sulmi dhe pa mundësi për të kërkuar drejtësi. Në veçanti, individët transgjinorë kanë qenë cak i vrasjeve brutale. Shumica e këtyre rasteve nuk hetohen dhe asnjë nuk ka rezultuar me ndjekje të suksesshme penale.³

Për ta adresuar këtë situatë, Asambleja Legjislative, Parlamenti me një dhomë i El Salvadorit, miratoi reformën e Kodit Penal në 2015. Reforma futi dënime më të ashpra për vrasje dhe kërcënime të motivuara nga urrejtja, "përfshirë në bazë të racës, përkatësisë etnike, pikëpamjeve politike, fesë, gjinisë, identitetit dhe shprehjes gjinore, orientimit seksual ose ndonjë ekuivalent tjetër".⁴

Ashtu si në El Salvador, në vitin 2014, Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës ndërmoi veprime për të korriguar faktin se krimet nga urrejtja nuk ishin adresuar në Kodin Penal të saj. Grupi Parlamentar i Grave në Dhomën e Përfaqësuesve të Federatës, dhoma e ulët e parlamentit, punoi me një koalicion të shoqërisë civile që po luftonte kundër gjuhës së urrejtjes dhe krimeve nga urrejtja. Grupi Parlamentar hartoi një ndryshim në Kodin Penal që përfshinte dispozita për krime nga urrejtja të kryera në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Më pas, Grupi Parlamentar i Grave dorëzoi në parlament një projektligj gjithëpërfshirës për ndryshime në Kodin Penal. Në shkurt 2016, Dhoma e Përfaqësuesve në Sarajevë e adoptoi projektligjin si ligj.⁵

4.2 Legjislacioni dhe strukturat efektive për trajtimin e DhBGj-së

Një parlament që kryen mbikëqyrje efektive mbi sektorin e sigurisë për të avancuar barazinë gjinore siguron miratimin e legjislacionit gjithëpërfshirës për të parandaluar, zbuluar, hetuar dhe për të ndjekur penalisht DhBGj-në. Legjislacioni do të duhej të përmbledhë të gjitha format e DhBGj, duke u përfshirë (por jo vetëm) ngacmimi seksual; dhuna në familje dhe përdhunimi martesor; përdhunimi mashkull-mashkull; martesë e detyruar, shtatzënia ose aborti; trafikimi për shfrytëzim seksual; gjymtimi gjenital; dhe vrasjet e nderit. Legjislacioni do të duhej të vendosë sanksione të përshtatshme për kryesit dhe mbështetje për viktimat.

Një sektor efektiv i sigurisë i mbron të gjithë, duke përfshirë gratë në të gjithë diversitetin e tyre (duke marrë parasysh moshën, aftësinë e kufizuar, etj.) dhe individët me orientime seksuale dhe me identitete dhe shprehje gjinore të ndryshme, nga dhuna dhe diskriminimi. Për shembull, kërkimet sugjerojnë që gratë me aftësi të kufizuara kanë më shumë të ngjarë të përjetojnë dhunë në familje, abuzim emocional dhe sulm seksual sesa gratë pa aftësi të kufizuara. Gratë me aftësi të kufizuara gjithashtu mund të ndihen më të izoluara dhe të paaftha për të raportuar abuzimin, ose mund të jenë të varura nga dhunuesi në kuptim të ofrimit të kujdesit. Diskriminimi në bazë të orientimit seksual ose identitetit dhe shprehjes gjinore përbëhet nga trajtimi i padrejtë apo dallimi arbitrar në bazë të orientimit seksual jo-

heteroseksual të vërtetë apo të perceptuar të një personi (për shembull, të qenit lezbike, gej ose biseksual), ose në bazë të asaj si personi e identifikon dhe shpreh gjininë e vet nga aspekti i pamjes, manierizmave dhe sjelljes.

Një parlament që kryen mbikëqyrje efektive të sektorit të sigurisë për të avancuar barazinë gjinore adreson paragjykimin dhe diskriminimin në bazë gjinore duke u angazhuar për reforma legjislative dhe të politikave, trajnime për personelin e sektorit të sigurisë, përfshirjen e më shumë grave në sektorin e sigurisë, verifikimin e pastërtisë së figurës për të përjashtuar kryesit e dhunës seksuale nga sektori i sigurisë dhe përmirësime në procedurat gjyqësore për të adresuar më mirë nevojat e të mbijetuarve dhe dëshmitarëve duke njohur nevojat e veçanta të grupeve të ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve. Përveç kësaj, parlamentet mund të shërbejnë si forum për rritjen e vetëdijes shoqërore për ndikimet gjinore të dhunës.

Në kontekstin e mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë për të avancuar barazinë gjinore, komisionet parlamentare luajnë rol të rëndësishëm në rishikimin e ligjeve ekzistuese kombëtare me qëllim që të sigurojnë që diskriminimi në bazë të gjinisë, orientimit seksual ose identitetit gjinor është i ndaluar rreptësisht, se ligjet kombëtare janë në përputhje me të drejtën dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, dhe që korniza legjislative ofron bazë të mjaftueshme për të parandaluar, zbuluar, hetuar dhe ndjekur penalisht, pa diskriminim, format e ndryshme të DhBGj-së. Për shembull, kur ligjet e dhunës në familje nuk vlejnë për çiftet e të njëjtit seks që bashkëjetojnë, kjo i bën të cenueshëm individët LGBTI. Gjatë rishikimit të ligjeve në lidhje me dhunën në familje, parlamentarët mund të sigurojnë që ligji mbron individët që nuk janë në një martesë tradicionale heteroseksuale kur ata janë viktimë të dhunës në familje.

Parlamentet luajnë rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen dhe ligjvënien lidhur me proceset e paqes - rol ky që përmendet në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së lidhur me Agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria. Organet rajonale, ku përfshihen Bashkimi Evropian, NATO dhe Unioni Afrikan, gjithashtu kanë zhvilluar korniza të forta rreth barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, duke theksuar rolin e parlamenteve në ndërtimin e paqes së qëndrueshme. Për shembull, neni 42 i Kornizës së Unionit Afrikan të vitit 2013 për Reforma në Sektorin e Sigurisë thotë se Unioni Afrikan:

... këshillon Shtetet Anëtare të inkurajojnë dhe mbështetin legjislaturat e tyre për të mbikëqyrur punën mbi sektorin e sigurisë. Përveç kësaj, [legjislaturat] do të bëjnë dhe miratojnë ligje, rregulla dhe rregullore të institucioneve përkatëse të sektorit të sigurisë dhe do t'i japin mandat Komisioneve të specializuara për të ushtruar mbikëqyrje në emër të legjislaturës dhe për të raportuar rregullisht mbi to.⁶

Vendimi nr. 7/14 i Këshillit të Ministrave të OSBE-së, për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave u bën thirrje të gjitha Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, duke përthekuar të gjithë aktorët përkatës përfshirë parlamentet, për të zhvilluar (ndër të tjera) politika gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara kombëtare që kanë për qëllim luftimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave.⁷

Konflikti i armatosur dhe trashëgimia e tij krijojnë sfida të veçanta dhe mundësi potenciale për mbikëqyrje të përgjegjshme gjinore nga ana e parlamenteve (shih Korniza 6). Gjatë reformimit të sektorit të drejtësisë pas konfliktit, parlamentarët mund të sigurojnë që DhBGj përfshihet në mandatin e komisioneve të së vërtetës dhe gjykatave speciale. Parlamenti kroat jep shembull të mirë se si duket adresimi i DhBGj-së gjatë konfliktit. Në vitin 2015, Kroacia miratoi Aktin e Luftës Atdhetare, i cili përcaktoi masa mbështetëse për gratë që ishin viktimë të dhunës seksuale në luftërat e viteve 1991-1995. Kjo kthesë rrënjësore legjislative e bëri Kroacinë prijëse në Evropë sa i përket legjislacionit për dhunën seksuale gjatë konfliktit.⁸

Korniza 6: Mbikëqyrja parlamentare në kontekstet e prekura nga konflikti

Parlamentet duhet të jenë të vetëdijshme për faktin se rolet gjinore pësojnë ndryshime të ndjeshme në kohë konflikti dhe në proceset e paqes pas konfliktit. Proceset e paqes ofrojnë mundësi unike për parlamentet për ta bërë mbikëqyrjen e tyre mbi sektorin e sigurisë më gjithëpërfshirëse dhe më të larmishme.

Gjatë konfliktit, gratë dhe burrat marrin përgjegjësi të reja. Për gratë shpesh kjo nënkupton shërbimin në role të kundërta nga ato tradicionale. Në fazën pas konfliktit, ka mundësi të reja për gratë që të integrohen në institucionet e sektorit të sigurisë dhe në parlament. Gratë po marrin pjesë gjithnjë e më shumë në negociata të paqes, konferenca të donatorëve dhe procese të tjera të planifikimit të rindërtimit. Bazuar në këto përvoja dhe falë pjesëmarrjes në luftë të armatosur, gratë po kërkojnë që të përfshihen në strukturat politike pas konfliktit.

Për më tepër, proceset e paqes mund të paraqesin mundësi që ish-luftëtarët e armatosur të kryejnë trajnime gjinore. Proceset e çarmatimit, demobilizimit dhe riintegritimit mund të paraqesin mundësi për të mbyllur hendekun gjinor - për shembull, femrave ish-luftëtare mund t'u jepet mundësia të anëtarësohen në institucionet e sektorit të sigurisë.

Një parlament që nxjerr legjislacion efektiv në lidhje me DhBGj-në, siguron që ligjet shkruhen në gjuhë të ndjeshme gjinore. Ai siguron që ligjet të mos përjashtojnë burrat ose gratë, ose të japin përshtypjen se vlejnë vetëm për një sektor të caktuar të popullatës. Për të shmangur përjashtimin dhe diskriminimin, legjislacioni dhe politika e sigurisë përdorin gjuhë që pranon se shoqëria, si dhe çdo institucion specifik, përbëhet nga grupe të ndryshme me nevoja të ndryshme. Gjuha e përshtatshme shërben gjithashtu si rikujtim që pozita të caktuara brenda sektorit të sigurisë nuk janë të rezervuara vetëm për burra ose vetëm për gra.⁹

Për ta adresuar më mirë DhBGj-në, në disa vende të Amerikës Latine janë krijuar stacione policore të specializuara për gratë. Ideja që qëndron pas stacioneve të tilla është se gratë ndihen më të lira të raportojnë dhunën seksuale kur nuk u duhet të ballafaqohen me policë meshkuj. Nikaragua është një vend që shquhet për suksesin e treguar në krijimin e stacioneve policore për gratë, duke shpërfaqur ndërlikimet që përfshihen në adresimin e DhBGj-së.* Edhe pse gratë nga Nikaragua që përjetuan DhBGj fillimisht dolën haptas në numër të madh, legjislacioni kombëtar i miratuar kohët e fundit ka shkuar një hap prapa. Ligji i ri kërkon që viktimat e DhBGj-së së pari të bëjnë përpjekje pajtimi me kryesin përpara se të ndërmerren hapa të mëtejshëm ligjorë, dhe kjo ka rezultuar me rënie të numrit të grave që dalin haptas për t'u ballafaquar me kryesit. Kjo tregon se është me rëndësi thelbësore që parlamentarët ta rishikojnë kornizën legjislative me qëllim të identifikimit të boshllëqeve ligjore ose ligjeve kundërthënëse që pengojnë përpjekjet për të trajtuar DhBGj-në. Për më tepër, parlamenti duhet të vlerësojë ndikimet e mundshme negative dhe pozitive të ndryshimeve të propozuara legjislative mbi burrat, djemtë, gratë dhe vajzat në të gjitha pjesët e shoqërisë.

4.3 Çështjet gjinore janë vënë në rrjedhat kryesore të buxhetimit

“Pushteti i kuletës” është në thelb të kompetencave parlamentare për menaxhimin e sektorit të sigurisë. Një parlament që kryen mbikëqyrje efektive mbi sektorin e sigurisë për të avancuar barazinë gjinore, ndërmerr qasje sistematike për integrimin e perspektivës gjinore në vlerësimin dhe miratimin e propozimeve buxhetore dhe prokurimeve. Kjo kërkon njohje të thellë të ndikimit që kanë politikat e qeverisë, alokimet buxhetore dhe shpenzimet të gratë, vajzat, burrat dhe djemtë, si dhe individët me prejardhje të ndryshme. Kjo nënkupton vlerësimin “nëse janë bërë supozime pa marrë parasysh çështjet gjinore apo supozime të njëanshme gjinore në lidhje me përfituesit e procesit ose politikës, kush është cak i procesit ose politikës, dhe nëse të gjitha grupet do të përfitojnë në mënyrë të barabartë”.¹⁰

* Diskutohet në Modulin 2, “Çështjet Gjinore dhe Policia”.

Rrjeti i Grave Parlamentare të Kepit të Gjelbër angazhohet për mbikëqyrjen e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Me ndihmën e ekspertëve për çështje gjinore dhe UN Women, rrjeti përgatiti një analizë të bazuar në rezultate të propozimit të buxhetit të vendit për vitin 2015. Më pas, rrjeti avokoi me sukses për rialokimin e fondeve për Programin e Forcimit të Barazisë dhe Drejtësisë Gjinore.¹¹ Mbikëqyrja legislative që rrjeti e bëri me ngulm rezultoi në një buxhet më të përgjegjshëm gjinor.

Serbia jep një shembull tjetër të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Qeveria e Serbisë futi zyrtarisht buxhetimin e përgjegjshëm gjinor kur Parlamenti serb adoptoi Ligjin e ri për Sistemin Buxhetor në vitin 2015. Ligji specifikon barazinë gjinore si një nga objektivat e buxhetit, që do të futet gradualisht dhe do të implementohet plotësisht deri në vitin 2020. Për të qenë në gjendje të plotësojnë kërkesat e ligjit, në vitin 2015 dhe 2016 nëpunësit civilë morën pjesë në trajnime që u koordinuan nga Trupi Koordinues për Barazinë Gjinore dhe Ministria e Financave.¹²

4.4 Parlamenti luan rol në planet kombëtare të veprimit për Agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria

Parlamenti që integron perspektivën gjinore dhe avancon barazinë gjinore është i zotuar ndaj implementimit të Agjendës Gratë, Paqja dhe Siguria (shih Korniza 7).

Korniza 7: Agjenda Gratë, Paqja dhe Siguria

Në vitin 2000 u bë kthesë rrënjësore me adoptimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Rezoluta njohu që gratë dhe burrat kanë përvoja të ndryshme në konflikt, nevoja të ndryshme pas konfliktit, këndvështrime të ndryshme mbi shkaqet dhe rezultatet e konfliktit dhe sjellin kontribute të ndryshme për procesin e ndërtimit të paqes. Më pas, Këshilli i Sigurimit i OKB-së adoptoi edhe nëntë rezoluta të tjera që adresojnë gratë dhe konfliktin, që së bashku përbëjnë Agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria: Rezolutat 1325 (2000), 1820 (2008), 1888 (2009), 1889 (2009), 1960 (2010), 2106 (2013), 2122 (2013), 2242 (2015), 2467 (2019) dhe 2493 (2019). Synimet e Agjendës Gratë, Paqja dhe Siguria janë:

- ✦ promovimi i barazisë gjinore dhe forcimi i pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje në të gjitha aspektet e parandalimit të konfliktit, proceset e paqes, operacionet dhe ndërtimit të paqes;
- ✦ përmirësimi i mbrojtjes së grave në mjediset e prekura nga konflikti dhe dhënia fund dhunës seksuale lidhur me konfliktin dhe mosndëshkimit për këto krime;
- ✦ sigurimi që angazhimi ndërkombëtar në mjediset e prekura nga konflikti adreson nevojat specifike të grave dhe përmirëson mbrojtjen e të drejtave të grave.

Agjenda Gratë, Paqja dhe Siguria thekson pjesëmarrjen e grave në vendimmarrjen e sigurisë dhe në sektorin e sigurisë, dhe qasjen e grave në drejtësi. Shih Kumtesën e Politikave "Agjenda Gratë, Paqja dhe Siguria nga Prizmi i Qeverisjes së Sektorit të Sigurisë" për diskutim të mëtejshëm.

Mbi 75 vende në të gjithë botën kanë adoptuar një PKV për Agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria.¹³ PKV-të për Agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria mund të luajnë rol të rëndësishëm në promovimin e barazisë gjinore brenda sektorit të sigurisë dhe në transformimin e sektorit të sigurisë për të qenë më i përgjegjshëm ndaj nevojave të ndryshme gjinore.*

Parlamentet mund të luajnë rol qendror në zhvillimin e PKV-ve për Agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria - për të siguruar mbajtjen e fokusit të Agjendës Gratë, Paqja dhe Siguria - dhe në monitorimin e implementimit të PKV-ve. Për shembull, 68 për qind e parlamenteve që marrin pjesë në Asambleenë Parlamentare të NATO-s e monitorojë implementimin e PKV-së në vendin e tyre.¹⁴ Parlamentet kanë një sërë mjetesh në dispozicion të tyre për të ushtruar mbikëqyrje mbi implementimin e PKV-ve, përfshirë debatet plenare, mbledhjet e komisioneve,

* Shih Modulin 1, për diskutimin mbi rolin e PKV-ve për Agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria në lidhje me qeverisjen e përgjegjshme gjinore të sektorit të sigurisë dhe RSS.

seancat e dëgjimit, pyetjet për ministrat, zyrtarët ose ekspertët e qeverisë, dhe përgatitjen dhe ekzaminimin e raporteve.

Në shumë vende, parlamentarët janë të angazhuar në hartimin dhe ekzaminimin e raporteve mbi implementimin qeveritar të Agjendës Gratë, Paqja dhe Siguria. Në Mbretërinë e Bashkuar, në vitin 2006 u krijua Grupi Parlamentar Gjithëpartiak për Agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria, duke bërë bashkë parlamentarë, politikëbërës dhe përfaqësues të shoqërisë civile për t'u përqendruar në implementimin që kryen Mbretëria e Bashkuar në lidhje me zotimet e saj për Agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria. Në bazë vjetore, ky grup shqyrton dhe vë nën thjerrëz raportin e qeverisë për implementimin e PKV-së, duke forcuar kështu llogaridhënien parlamentare dhe publike.¹⁵

Pyetjet dhe mocionet mund të jenë masa efektive. Parlamentarët përdorin pyetjet për t'iu përgjigjur urgjencave, ngjarjeve aktuale dhe prioritetëve që dalin. Për shembull, Parlamenti gjerman mori në pyetje qeverinë federale gjermane për dhunën seksuale në misionet ndërkombëtare disa muaj pasi u zbulua se anëtarët e stafit të Oxfam kishin shfrytëzuar seksualisht viktimat e tërmetit të vitit 2010 në Haiti. Një ndërhyrje e ngjashme u bë në Holandë, ku në vitin 2016, në Dhomën e Përfaqësuesve u paraqit mocion në seancë plenare duke i kërkuar Ministrin të Mbrojtjes të sigurojë ekspertizë gjinore me orar të plotë brenda Ministrisë së Mbrojtjes dhe në kuadër të operacioneve të saj, dhe të lehtësojë pjesëmarrjen e grave në të gjitha pjesët e Ministrisë.

Parlamentet gjithashtu mund të përdorin kompetencat e tyre buxhetore për të mbikëqyrur shpenzimet e qeverisë për implementimin e Agjendës Gratë, Paqja dhe Siguria. Në Kanada, për shembull, Komisionet e Përhershme parlamentare për Punë të Jashtme dhe Zhvillim Ndërkombëtar dhe për Mbrojtjen Kombëtare mblidhen të paktën tri herë në vit për të shqyrtuar shpenzimet e departamenteve qeveritare përgjegjëse për implementimin e Agjendës Gratë, Paqja dhe Siguria. Në vitin 2018, kjo mbikëqyrje nënkuptoi që parlamentarët mund t'i bënin pyetje Ministrin të Mbrojtjes Kombëtare. Pyetjet u përqendruan në rekrutimin e grave, zotimet e Ministrisë së Mbrojtjes për operacionet e paqes dhe politikat e saj për eliminimin e sjelljeve të dëmshme dhe të pahijshme seksuale brenda ushtrisë.¹⁶

Fusnotat

1. DCAF (2015) "Parliaments: Roles and responsibilities in good security sector governance", SSR Backgrounder Series, Geneva: DCAF, p. 12.
2. Ky shembull është marrë nga A. Fofana Ibrahim, A. Sivalie Mbayo and R. McCarthy (2015) "Integrating gender in security sector reform and governance", në O. Moderan and L. Boström (eds) Toolkit for Security Sector Reform and Governance in West Africa, Geneva: DCAF.
3. Parliamentarians for Global Action (2019) "Parliamentarians driving progressive law reform", 3 March, <https://www.pgaction.org/inclusion/case-studies/parliamentarians-driving-progressive-law-reform.html>.
4. Po aty.
5. Po aty.
6. African Union (2013) "Policy framework on security sector reform", Addis Ababa: African Union Commission.
7. OSCE (2014) "Preventing and combating violence against women", OSCE Ministerial Council Decision No. 7/14.
8. S. Ferbach and A. Reeves (2018) "The role of parliaments in NATO member countries in advancing the Women, Peace and Security Agenda", Geneva: DCAF, p. 12.
9. Fofana Ibrahim et al., shënimi 2 më sipër, f. 72.
10. IPU and UNDP (2017) "Global parliamentary report 2017 – Parliamentary oversight: Parliament's power to hold government to account", Tignieu-Jameyzieu: Courand et Associés, p. 20.
11. AGORA Portal for Parliamentary Development (2016) "Parliamentary oversight of gender equality", 26 shkurt, <https://agora-parl.org/interact/blog/parliamentary-oversight-gender-equality> (qasur më 1 shtator 2019).
12. UN Women and Government of Serbia (2018) "Gender responsive budgeting: An emerging Serbian best practice in managing public finance reform for gender equality, 2008 - 2017", https://www.undp.org/content/dam/unct/serbia/docs/Publications/UNW_GRB_03%202017_ENG_digital_0030%20FINAL.pdf, qasur më 9 dhjetor 2019.
13. Shih përmbledhjen e informacionit për PKV-të, në uebsajtin Women's International League for Peace and Freedom (WILPF) PeaceWomen, <http://peacewomen.org>.
14. Ferbach and Reeves, shënimi 8 më lart.
15. Gender Action for Peace and Security (2019) "All-Party Parliamentary Group on Women, Peace and Security", <http://gaps-uk.org/about/appg/> (qasur më 9 dhjetor 2019).
16. Ferbach and Reeves, shënimi 8 më lart, f. 16.



5. Si mund ta ndihmojë mbikëqyrja parlamentare e sektorit të sigurisë avancimin e barazisë gjinore dhe integrimin e perspektivës gjinore?

Kjo pjesë përshkruan disa mekanizma kryesorë me të cilët mund të forcohet mbikëqyrja parlamentare mbi sektorin e sigurisë në mënyrë që të avancohet barazia gjinore. Strategjia ombrellë është integrimi i perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e punës parlamentare. Siç përshkruhet nga Programi për Zhvillim i OKB-së:

Njësimi i çështjeve gjinore brenda degës legjislative është transformimi i brendshëm i institucionit ("si bëhet puna"), i rezultateve të tij ("çka rregullohet me ligj" dhe "çfarë përmbajtje ka legjislacioni") dhe i lidhjeve të tij ("me kë bën dialog", "kë e kontrollojnë", "kujt i jep llogari").¹

Për të integruar perspektivën gjinore në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë ka mekanizma më specifike, si më poshtë:

- ◆ analiza gjinore e sektorit të sigurisë, duke përfshirë shqyrtimin e hollësishëm të buxhetit
- ◆ angazhimi i infrastrukturës së dedikuar për çështjet gjinore, siç është komisioni parlamentar për barazinë gjinore ose grupi parlamentar i grave, në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë
- ◆ proceset gjithëpërfshirëse, duke shtrirë veprimtarinë te komunitetet
- ◆ forcimi i bashkëpunimit me institucionet e ombudspersonit të angazhuara në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë
- ◆ arritja e paritetit gjinor brenda parlamentit.

5.1 Analiza gjinore e sektorit të sigurisë, përfshirë shqyrtimin e hollësishëm të buxhetit

Integrimi i perspektivës gjinore në mbikëqyrje përfshin marrjen parasysh se *kush* e kryen një proces ose e zbaton një politikë, *si* kryhet ose zbatohet, për çfarë *qëllimi*, dhe nëse procesi ose politika *promovon barazinë gjinore*. Në këtë mënyrë, mbikëqyrja e përgjegjshme gjinore e sektorit të sigurisë kërkon vënien nën thjerrëz të ligjeve, buxheteve, politikave dhe praktikave të sektorit të sigurisë, me qëllim të sigurimit që nevojat dhe prioritetet e sigurisë për të gjithë burrat dhe gratë, pavarësisht nga orientimi i tyre seksual dhe identiteti apo shprehja gjinore, janë marrë parasysh, dhe që institucionet e sektorit të sigurisë respektojnë, mbrojnë dhe plotësojnë të drejtat e njeriut për të gjithë, përfshirë edhe sa i përket personelit të tyre.

Bërja e kësaj kërkon kuptim, njohuri dhe aftësi. Pikë së pari dhe më e rëndësishmja është të kryhet analiza gjinore: një ekzaminim kritik se si ndryshimet në rolet gjinore, aktivitetet, nevojat, mundësitë dhe të drejtat/prerogativat ndikojnë te gratë, burrat, vajzat dhe djemtë (pavarësisht nga orientimi i tyre seksual dhe identiteti apo shprehja gjinore) në një fushë, situatë apo kontekst të caktuar të politikave.*

* Moduli 15, "Integrimi i Çështjeve Gjinore në Hartimin dhe Monitorimin e Projekteve për Sektorin e Sigurisë dhe Drejtësisë", paraqet qasjet ndaj analizës gjinore, përfshirë gamën e mjeteve për analizë gjinore që mund të përdoren nga parlamentarët.

Foto: Gjashtë anëtarë të Komisionit gjithë-partiak për të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjinore në Parlamentin Evropian, 2011 © European Union 2011 PE-EP/Pietro Naj-Oleari.

Së këndejmi, është thelbësore të ndërtohen kapacitetet gjinore të parlamentarëve meshkuj dhe femra, veçanërisht anëtarëve të komisioneve të mbrojtjes dhe sigurisë, përmes kumtesave informative, trajnimeve dhe iniciativave të tjera të vetëdijesimit. Në të vërtetë, parlamentet si hapësirë pune mund të jenë vend kritik “për të diskutuar çështjet thelbësore të barazisë gjinore, përfshirë pagën e barabartë, barazinë në avancim, pushimin prindëror, dhënien fund ngacmimit seksual në vendin e punës dhe promovimin e orarit më fleksibël të punës për të mbështetur ekuilibrin më të mirë të punës dhe jetës private dhe ndarjen më të drejtë të punës prindërore dhe të përkujdesjes”.² Nëse parlamentarët kanë të paktën kuptim themelor të analizës gjinore, kjo i fuqizon ata që të bëjnë pyetje të rëndësishme dhe të kërkojnë të dhëna të rëndësishme.

Parlamentarët gjithashtu do të duhej të jenë në gjendje t'i besojnë stafit dhe departamenteve të tyre kërkimor për të kryer punën e nevojshme për të mbështetur integrimin e perspektivës gjinore. Shërbimet e kërkimit parlamentar mund të jenë të përshtatshme për të ofruar analiza objektive dhe të thukëta për të ndihmuar parlamentarët në mbikëqyrjen e çështjeve komplekse të sektorit të sigurisë, nga perspektiva gjinore.

Në Fixhi u krijua një komision parlamentar gjinor për të siguruar që konsideratat gjinore merren parasysh në punën e të gjitha komisioneve dhe reflektohen në raportet përkatëse që i paraqiten parlamentit. Për më tepër, Parlamenti fixhian ka adoptuar një “paketë të instrumenteve gjinore” për t'i ndihmuar anëtarët e komisionit në kryerjen e vlerësimeve të ndikimit gjinor në tërë legjislacionin, duke përfshirë buxhetin.³ Paketa thekson rëndësinë e mbledhjes së të dhënave të zberthyer sipas seksit. Sipas fjalëve të Jiko Luveni, Kryetar i Parlamentit, “Urdhrat e Përhershëm të Parlamentit kërkojnë që komisionet parlamentare ta përdorin analizën në bazë gjinore kur shqyrtojnë legjislacionin ose ndërmarrin funksionet e tyre mbikëqyrëse”.⁴ Trajnimi gjinor, siç bëhet në Fixhi, mund të jetë masë efektive për të bindur parlamentarët meshkuj dhe femra për rëndësinë e mbikëqyrjes së përgjegjshme gjinore.

Një formë specifike e analizës gjinore është kryerja e “auditimit gjinor”. Në punën parlamentare, auditimet gjinore të të gjitha buxheteve të propozuara dhe ekzistuese ndihmojnë për të zbuluar shkallën në të cilën pabarazia gjinore ka ndikim te siguria dhe për të përcaktuar se cilat prioritete të sigurisë së burrave, grave, djemve dhe vajzave, si dhe të personave me prejardhje të larmishme duke përfshirë edhe diversitetin e orientimit seksual dhe të identitetit dhe shprehjes gjinore, kërkojnë fonde. Kur parlamenti diskuton buxhetin e përgjithshëm, ai do të duhej ta vendosë barazinë gjinore si synim me prioritet në procedurat buxhetore. Procedurat e tilla mund të “sigurojnë që alokimet janë në përputhje me zotimet e politikave për barazinë gjinore, rritin transparencën dhe verifikojnë nëse shpenzimet po sjellin ndikimin e dëshiruar”.⁵

Një auditim gjinor mund të konstatojë nëse buxhetet për të gjithë aktorët e sektorit të sigurisë janë të përgjegjshme nga aspekti gjinor. Nga ana tjetër, buxheti i përgjegjshëm gjinor forcon legjitimitetin e funksionit mbikëqyrës të parlamentit. Auditimet gjinore do të duhej të bazohen në metodologji pjesëmarrëse që:

- ◆ konsideron nëse praktikata e brendshme dhe sistemet e ndërlidhura të mbështetjes për njësimin e çështjeve gjinore janë efektive dhe përforcojnë njëra-tjetrën;
- ◆ monitoron dhe vlerëson progresin relativ të shënuar në njësimin e çështjeve gjinore;
- ◆ përcakton skenarin bazë për njësimin e audituar;
- ◆ identifikon boshllëqet dhe sfidat kritike;
- ◆ rekomandon mënyrat për t'i adresuar këto boshllëqe dhe sfida, dhe sugjeron strategji të reja dhe efektive;
- ◆ dokumenton praktikata e mira që kanë për qëllim arritjen e barazisë gjinore.⁶

Afrika e Jugut ishte një nga vendet e para që futi perspektivën gjinore në procesin e saj buxhetor. Në vitin 1995, rreth një vit pas zgjedhjeve të para demokratike të vendit, u realizua Nisma e Grave për Buxhetin e Afrikës së Jugut si përpjekje e përbashkët nga ana e parlamentarëve dhe

disa organizatave të shoqërisë civile. Nisma e Grave për Buxhetin analizoi të gjitha alokimet sektoriale të buxhetit të qeverisë nga perspektiva gjinore për të përcaktuar ndikimet e saj diferenciale të gratë, burrat, vajzat dhe djemtë. Ideja prapa kësaj ishte që të analizohen të gjitha format e shpenzimeve publike ose metodat e arkëtimit të të hyrave në kontekstin e përfitimeve që do të lindnin për gratë dhe vajzat në raport me burrat dhe djemtë. Faza e parë e nismës u përqendrua në katër sektorë - mirëqenie, arsim, strehim dhe në Programin e Rindërtimit dhe Zhvillimit. Faza e dytë përfshiu fusha të tilla si shëndetësia, drejtësia, mbrojtja dhe siguria, shërbimet korrektuese, transporti, punët e brendshme dhe të jashtme, bujqësia, çështjet tokësore dhe energjia.⁷ Është domethënëse që çelësi i suksesit ishte bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet parlamentarëve dhe organizatave të shoqërisë civile.

5.2 Angazhimi i strukturave parlamentare gjinore në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë

Siç shpjegohet në pjesën 2, funksioni i mbikëqyrjes mbi sektorin e sigurisë nga parlamentet ka tendencë të përqendrohet te komisionet për siguri dhe mbrojtje. Ato mund të hetojnë aktivitetet e forcave të sigurisë dhe të ofrojnë një forum publik për partitë politike për të pleqëruar mbi politikën dhe aktivitetet e sigurisë. Komisionet parlamentare për sigurinë dhe mbrojtjen do të duhej të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë në mënyrë aktive me strukturat parlamentare të dedikuara për çështjet gjinore - që më së shpeshti është komisioni që si fokus të veçantë ka barazinë gjinore, ose grupi parlamentar i grave.

Në vitin 2015, në 116 vende të botës ekzistonin 144 organe parlamentare me mandat për të adresuar barazinë gjinore. Si shembuj të këtyre organeve përfshihen Komisioni Këshillues për Mundësi të Barabarta për Burrat dhe Gratë në Belgjikë, Komisioni i Përhershëm i Dhomës së Ulët për Statusin e Grave në Kanada, Komisioni për Fuqizimin e Grave në Indi, Komisioni për Barazi në Spanjë, Komisionet e Përhershme për Çështje Gjinore në Republikën Dominikane, Komisioni për Mundësi të Barabarta i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Komisioni për Barazi Gjinore i Parlamentit të Malit të Zi, Komisioni Mbikëqyrës Sektorial për Gratë dhe Çështjet Gjinore i Parlamentit të Shri Lankës, Komisioni për Barazi Gjinore i Parlamentit Danez, Komisioni për Çështje të Punës dhe Barazisë në Finlandë, Komisioni për Mundësi të Barabarta i Dhomës së Përfaqësuesve në Bosnjë dhe Hercegovinë, Komisioni për Çështje Gjinore dhe të Fëmijëve i Parlamentit të Ganës dhe Grupi Parlamentar i Grave në El Salvador. Rol thelbësor i këtyre komisioneve është të mbajnë dëgjime publike dhe të konsultohen me komunitetin e politikave për të përcaktuar efektet e politikave, programeve dhe legjislacionit mbi gratë, burrat, vajzat dhe djemtë. Në Moldavi, për shembull, Komisioni i Grave ka kërkuar ekspertizë nga Platforma për Barazi Gjinore, e cila përfshin 19 organizata të shquara të shoqërisë civile.⁸

Një grup parlamentar i grave mund të bëjë bashkë gratë përtej vijave partiake. Grupet parlamentare ndërpartiake të grave ekzistojnë, ndër të tjera, në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kirgizi, Maqedoni të Veriut, Poloni, Sllovaki dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.⁹ Një studim i OSCE/ODIHR mbi strukturat për gratë deputete në rajonet e OSBE-së zbuloi se ndërsa lloji i sistemit parlamentar dhe politik në vend me sa duket nuk ndikon drejtpërdrejt në shfaqjen e një organi parlamentar të grave, mjedisi politik mund të ndikojë lidhur me llojin e organit. Po kështu, ekzistenca e kuotave gjinore ligjore ose masave vullnetare për të mbështetur zgjedhjen e grave në parlament me sa duket nuk është tregues i drejtpërdrejtë i gjasave për krijimin e një organi parlamentar të grave. Megjithatë, shumë organe parlamentare të grave kanë luajtur rol kyç në avokimin për futjen e dispozitave të kuotës gjinore në ligjet zgjedhore, në lobimin për ndryshime në dispozitat e kuotës gjinore dhe/ose në monitorimin e implementimit të dispozitave për kuota.¹⁰

Shembull i mirë i grupit parlamentar të grave është Shoqata e Grave Parlamentare dhe ish-Parlamentare në El Salvador. Kur u themelua shoqata, pozita e presidentes i përkiste Frontit Nacionalçlirimtar Farabundo Martí, një lëvizje ish-guerile dhe nënkryetarja ishte nga partia e krahut të djathtë ARENA që ishte përfshirë në aktivitete të skuadrave të vdekjes kundër

guerilëve përgjatë viteve 1980. Ajo u bë simbol për gratë dhe burrat në parlament sa i përket mënyrës se si dialogu ishte i mundur përtej vijave armiqësore partiake.¹¹ Synimi kryesor i shoqatës është të ofrojë trajnime për gratë parlamentare mbi aftësitë udhëheqëse.¹²

5.3 Proceset gjithëpërfshirëse, puna afruese me shoqërinë civile

Struktura e komisionit është një mekanizëm i rëndësishëm përmes të cilit parlamentet mund të kërkojnë kontribute nga shoqëria civile dhe ekspertët e tjerë lidhur me çështjet e sigurisë. Përtej angazhimit nëpërmjet grupit parlamentar të grave apo komisionit për barazi gjinore, komisionet parlamentare të mbrojtjes dhe sigurisë dhe komisionet e barazisë gjinore do të duhej të bëjnë punë afruese me organizatat e grave, ekspertët e çështjeve gjinore dhe organizatat e shoqërisë civile që merren me sektorin e sigurisë ose përqendrohen te të drejtat e njeriut.

Komisionet do të duhej të sigurojnë kryerjen e konsultimeve domethënëse me grupet e ndryshme (shih Korniza 8). Parlamentet mund të përdorin mjete të ndryshme për ndërveprim me shoqërinë civile, siç është bërja e dialogut kombëtar, organizimi i konsultimeve publike, duke përfshirë dëgjimet publike parlamentare për ligjet e propozuara, dhe kërkimi i prezantimeve nga ekspertët. Për shembull, një nga mënyrat me të cilat Austria është përpjekur të adresojë DhBGj-në është përfshirja e shoqërisë civile në pleqërimet e Komisionit për Barazi Gjinore. Në vitin 2018, komisioni ndërmori një nismë të veçantë kundër DhBGj-së në koordinim me sektorin jo-qeveritar, duke integruar perspektivat nga shoqëria civile.¹³

Korniza 8: Kryerja e konsultimeve të larmishme dhe gjithëpërfshirëse

Përfaqësuesve të grupeve të larmishme të burrave dhe grave, përfshirë personat LGBTI, do të duhej t'u jepet mundësia të marrin pjesë në proceset e reformës ligjore dhe mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë. Kjo është thelbësore për të siguruar që nevojat e larmishme të komuniteteve dëgjohen dhe adresohen. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të mbani mend se as gratë, as burrat dhe as personat LGBTI nuk janë grupe homogjene, dhe për këtë arsye është e nevojshme të përfshihet një larmi grupesh për të sjellë përvoja, nevoja dhe pikëpamje të larmishme në përgatitjen e reformave.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të grupeve të larmishme në proceset e reformës ligjore dhe mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë do të duhej të jetë:

- ✦ gjithëpërfshirëse - në numër të mjaftueshëm
- ✦ domethënëse - në role vendimmarrëse dhe me ndikim
- ✦ gjatë gjithë procesit - nga fillet e reformës përgjatë implementimit të reformave deri te vlerësimi.

Duhet në mënyrë aktive të shmangët Tokenizmi (konsultimi me vetëm një numër të vogël të "njerëzve të larmishëm" thjesht si demonstrim formal i gjithëpërfshirjes) ose angazhimi vetëm pasi të jenë marrë vendimet kryesore!

Funksioni i mbikëqyrjes nga ana e parlamenteve mund të përfshijë marrjen e informacioneve, në baza të rregullta, nga organizatat e shoqërisë civile dhe shoqatat e personelit femër në sektorin e sigurisë në lidhje me statusin e grave në këtë sektor dhe çështjet që aktualisht i preokupojnë ato. Sipas nevojës, do të duhej të konsultohen edhe grupet për të drejtat e viktimave dhe organizatat e tjera përkatëse. Konsultimet e tilla me shoqërinë civile i bëjnë parlamentet më përfaqësuese dhe më efektive në funksionin e tyre mbikëqyrës. Bazuar në informacionin e marrë, parlamentet mund ta marrin në pyetje ekzekutivin dhe, nëse është e nevojshme, të miratojnë legjislacion për të adresuar abuzimet.

5.4 Bashkëpunimi ndërmjet parlamenteve dhe institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut dhe institucioneve të ombudspersonit për të garantuar mbikëqyrje efektive mbi sektorin e sigurisë

Siç theksohet në pjesën 2, IKDNj-të dhe institucionet e ombudspersonit luajnë rol të rëndësishëm në monitorimin e institucioneve të sektorit të sigurisë. Ato marrin dhe hetojnë ankesat nga personeli i sektorit të sigurisë publike dhe/ose nxjerrin raporte dhe rekomandime. Dhuna e lidhur me çështjet gjinore është e përhapur në institucionet e sektorit të sigurisë në shumë vende, dhe mund të përfshijë dhunën ndaj personave që mbahen në ndalim ose ndaj viktimave të krimit, pastaj abuzim të anëtarëve të familjes së personelit ose anëtarëve të tjerë të komunitetit. Hetimi dhe raportimi nga IKDNj-të dhe institucionet e ombudspersonit mund të ndihmojnë për të identifikuar, adresuar dhe frenuar sjelljen problematike nga ana ose brenda sektorit të sigurisë, si dhe të nxjerrë në pah mangësitë institucionale. Në këtë kuptim, një IKDNj ose zyra e ombudspersonit mund të shihet si aleat kryesor për funksionin e mbikëqyrjes parlamentare. Në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë, parlamenti heton ankesat, rrit vetëdijen për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe siguron respektim të politikave kombëtare dhe sundimit të ligjit.

Bashkëpunimi ndërmjet IKDNj-ve dhe institucioneve të ombudspersonit në një vend dhe parlamentit të tij mund të jetë mekanizëm efektiv për avancimin e barazisë gjinore dhe adresimin e DhBGj-së. Në shumicën e vendeve, IKDNj-të dhe institucionet e ombudspersonit i raportojnë parlamentit çdo vit. Raportet e tyre ofrojnë pasqyrë të çështjeve kryesore të të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë në veprimet dhe praktikat e institucioneve shtetërore që shkelin të drejtat e njeriut. Ato u japin komisioneve parlamentare njohuri “mbi situatën e përgjithshme në shërbimet e sigurisë dhe gjendjen morale të personelit të tyre”.¹⁴ Ato mund të kërkojnë nga parlamenti që të parandalojë dhe të korrigojë abuzimet e të drejtave të njeriut duke iniciuar legjislacion përkatës; për shembull, duke avokuar që parlamenti të adoptojë legjislacion të ndjeshëm gjinor që merr parasysh nevojat dhe përvojat e ndryshme të grave dhe burrave.

Parlamentet mund të mbështeten në informacionin e dhënë nga IKDNj-të dhe institucionet e ombudspersonit për të iniciuar seanca dëgjimi për abuzimet e raportuara dhe mund të jenë në gjendje t'i kërkojnë atyre që të raportojnë për çështje specifike, siç janë nevojat specifike të grave dhe vajzave.*

Departamenti për Barazi Gjinore i Mbrojtësit Publik të Gjeorgjisë është shembull i mirë se si punon një institucion i ombudspersonit për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut për të gjithë qytetarët, veçanërisht ata që janë me risk të cenueshmërisë, siç janë gratë dhe komuniteti LGBTI. Në raportin për vitin 2016 për Gjeorgjinë, Raportuesja e Posaçme e OKB-së për Dhunën ndaj Grave, Shkaqet dhe Pasojat e Saj, përsëriti thirrjen e saj drejtuar të gjitha shteteve për të krijuar një “rojë femicidi” ose “rojë të vrasjes së grave në bazë gjinore”. Ajo sqaroi se qëllimi prapa kësaj ishte të “mblidhen dhe publikohen të dhëna [vjetore] për numrin e femicideve [të kryera] dhe të krijohet ose [t'i besohet një organi ekzistues për të analizuar çdo rast të femicidit, në mënyrë që të identifikohet çdo dështim i mbrojtjes, me qëllim që [të] përmirësohen masat për të parandaluar femicidet”.¹⁵ Në prill 2017, Mbrojtësi Publik i Gjeorgjisë mori përsipër përgjegjësinë për monitorimin e vrasjeve të grave në bazë gjinore. Në vitin 2018, Mbrojtësi Publik paraqiti në parlament gjetjet paraprake nga monitorimi: një analizë të gjashtë femicideve dhe katër femicideve në tentativë të kryera në vitin 2016. Analiza e Mbrojtësit Publik identifikoi boshllëqet në mbledhjen e të dhënave, si thelbësore për adresimin e mangësive në mbrojtjen e të mbijetuarave. Analiza gjithashtu bëri thirrje për futjen e shprehjes “femicid” në Kodin Penal, për të lehtësuar kualifikimin juridik të krimit, forcimin e proporcionalitetit të sanksioneve dhe përmirësimin e sistemit për mbrojtjen e viktimave.¹⁶

* Për më shumë informacione mbi IKDNj-të dhe barazinë gjinore, shih OSCE/ODIHR's (2012) *Handbook for National Human Rights Institutions on Women's Rights and Gender Equality* dhe DCAF, OSCE/ODIHR, OSCE's (2014) guidance note, *Integrating a Gender Perspective into Oversight of the Security Sector by Ombuds Institutions & National Human Rights Institutions*.

Në vitin 2019, Qendra e Parandalimit të Konfliktëve pranë Sekretariatit të OSBE-së dhe Zyra për Institucione Demokratike iniciuan procesin që çon në krijimin e një platforme ndër-institucionale ku organet mbikëqyrëse takohen për të diskutuar qeverisjen dhe reformat e sektorit të sigurisë në Republikën e Armenisë. Platforma synon të bëjë bashkë organet e mbikëqyrjes (Asambleja Kombëtare, Zyra e Mbrojtjesit të të Drejtave të Njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile) me institucionet e sektorit të sigurisë dhe drejtësisë (Këshilli i Sigurisë Kombëtare, Ministria e Mbrojtjes, policia, Shërbimi i Sigurisë Kombëtare, Komisioni Hetues, Prokuroria dhe Shërbimi Hetues Special). Ajo gjithashtu përfshin Këshillin Suprem Gjyqësor. Platforma do të shqyrtojë rregullisht integrimin e perspektivës gjinore në kornizat e sigurisë.

5.5 Arritja e barazisë gjinore brenda parlamentit

Përfaqësimi jashtëzakonisht i ulët i grave në shumicën e parlamenteve diskutohet në pjesën 3, në kontekstin e rëndësisë që parlamenti të jetë përfaqësues sa i përket burrave dhe grave, si për hir të legjitimitetit, ashtu edhe për cilësinë e mbikëqyrjes së tij. Strategjitë e rëndësishme për integrimin e perspektivës gjinore në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë janë, pra, të rritet numri i kandidatëve femra për t'u bërë deputete dhe të rritet numri i grave që zgjidhen për parlament, dhe të sigurohet që gratë të mbajnë pozita udhëheqëse brenda parlamentit pasi të jenë zgjedhur. E ashtuquajtura “masë kritike” e grave deputete prej të paktën 30 për qind, pranohet gjerësisht si pikë referimi për standardet minimale. Përveç kësaj, përbërja e listës së kandidatëve për parlament duhet të jetë gjithëpërfshirëse në kuptim të komuniteteve LGBTI, si dhe grupeve të tjera që tradicionalisht janë të nën-përfaqësuara, siç janë gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë e reja.

Siç vërehet në pjesën 3, gjatë dy dekadave të fundit është shënuar përmirësim i dukshëm në pjesëmarrjen e grave në parlamente në nivel global. Ky progres është në masë të madhe rezultat i futjes së masave të veçanta të përkohshme, siç janë kuotat ose ulëset e rezervuara. Siç ka vërejtur Komiteti CEDAW, kuotat dhe ulëset e rezervuara nuk do të duhej të konsiderohen diskriminim ndaj burrave; përkundrazi, ato përbëjnë masa të veçanta të përkohshme për të zhbërë pabarazitë dhe trendet historike.¹⁷ Efikasiteti dhe ndikimi i këtyre masave ndryshojnë. Kirgizia dhe Irlanda janë shembuj ku kuotat kanë sjellë rezultate pozitive. Por, masat e veçanta të përkohshme janë po aq efektive sa formulimi dhe implementimi i tyre, dhe nuk ka një model universal të përshtatshëm për të gjitha vendet.¹⁸ Kuotat legislative, edhe pse ligjërisht detyruese, jo gjithmonë prodhojnë automatikisht ndryshimet e dëshiruara në numrin e grave të zgjedhura. Në të njëjtën kohë, kuotat e brendshme partiake, megjithëse vetëm masa vullnetare, kanë qenë më efektive në arritjen e përfaqësimit më të madh të grave në disa vende.

Në diskutimin për numrin e grave, nganjëherë më pak vëmendje i kushtohet rezultateve - me fjalë tjera, ndikimit që ka në barazinë gjinore pjesëmarrja e grave në parlamente. Parlamentet shpesh janë “të zhytura në norma, praktika dhe politika që i diskriminojnë gratë dhe që e bëjnë të vështirë për gratë të bëjnë ndryshime”.¹⁹ Për shembull, përmirësimi i proporcionit të grave parlamentare jo medoemos çon në rol aktiv për gratë në vendimmarrjen lidhur me sigurinë, siç është mbajtja e posteve ministrore ose të larta në komisionet përgjegjëse për mbrojtjen dhe policinë (shih Korniza 9). Sa për ilustrim, më 1 janar 2019 gratë mbanin gjithsej 1,412 portofole ministrore brenda qeverive; prej këtyre, gratë zunë vetëm 22 portofole për çështjet e mbrojtjes dhe/ose të veteranëve, 50 për punët e brendshme dhe/ose emigracionin dhe 31 për drejtësi.²⁰ Në të njëjtën kohë, shumica e komisioneve parlamentare për barazi gjinore kanë anëtarësi që përbëhet kryesisht nga gratë. Mirëpo, komisionet e larmishme kanë më shumë gjasa të kuptojnë nevojat gjinore të zgjedhësve të tyre rreth sigurisë. Nga ana tjetër, ky kuptim i zgjeruar forcon legjitimitetin e komisioneve të tilla.

Korniza 9: Komisioni Parlamentar Austriak për Forcat e Armatosura Federale

Austria ofron shembull të mirë të sfidave dhe avancimeve në mbikëqyrjen nga komisionet. Komisioni Parlamentar Austriak për Forcat e Armatosura Federale përfaqëson parimin demokratik të sistemit juridik austriak në sferën ushtarake. Ky institucion është organ i pavarur monitorues i Këshillit Kombëtar të Parlamentit Austriak.

Komisioni fillimisht kishte në krye Ministrin e Mbrojtjes, i cili e kufizoi shumë pavarësinë e tij, por me kalimin e viteve ai është shndërruar në një organ të pavarur që nuk është më subjekt i direktivave nga ministri. Tani, madje edhe kur anëtarët e Komisionit humbasin ulëset e tyre në parlament, ata shërbejnë në Komision deri në fund të mandatit të tyre të plotë gjashtë vjeçar.

Në vitin 2016, Komisioni filloi një nismë të veçantë gjinore, synimi i së cilës është njësimi i çështjeve gjinore në mbarë forcat e armatosura. Një fokus i veçantë është të sigurohet avancimi i grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Austria ka shërbim të detyrueshëm ushtarak që u hap për gratë vetëm në dy dekadat e fundit. Që nga viti 1998, grave u është dhënë mundësia për shërbim vullnetar në forcat e armatosura. Në vitin 2018, gratë përbënin 10–13 për qind të forcave të armatosura.

Në vitin 2018, Komisioni mbizotërohej nga deputetët e gjinisë mashkullore: asnjëri nga kryesuesit dhe vetëm dy prej anëtarëve ishin gra. Diversiteti i kufizuar i Komisionit shpjegohet me faktin se partitë politike të Austrisë janë të prira të propozojnë si kandidatë për Komision figurat kryesore për sektorin e mbrojtjes. Nga ana tjetër, tendenca është që këta të jenë ekskluzivisht të gjinisë mashkullore. Së këndejmi, në mënyrë që Komisioni të jetë i përgjegjshëm nga aspekti gjinor është e nevojshme të ndryshojnë kulturat institucionale.

Burimet: "Komisioni Parlamentar Austriak për Forcat e Armatosura Federale", uebsajti i parlamentit të Austrisë; intervistë me deputetin Michael Hammer, Drejtor Ekzekutiv i Komisionit Parlamentar Austriak për Forcat e Armatosura Federale, Austri, 9 tetor 2018; intervistë me Gisela Wurm, anëtare e Komisionit Parlamentar Austriak për Forcat e Armatosura Federale dhe Kryesuese e Komisionit Parlamentar për Barazi Gjinore (2008–2017), Austri, 13 tetor 2018; intervistë me deputetin Otto Pendl, Drejtor i Komisionit Parlamentar Austriak për Forcat e Armatosura Federale, Austri, 13 tetor 2018.

Për të përqafuar barazinë gjinore si vlerë për të gjithë punën parlamentare, parlamentarët meshkuj dhe femra duhet të punojnë së bashku për të transformuar kulturën institucionale dhe për të kapërcyer paragjykimet e kamotshme. Mund të gjenden stimuj për deputetët e gjinisë mashkullore për të marrë pjesë në komisionet e barazisë gjinore në një numër më të madh. Deputetët femra mund të përcaktohen me prioritet për komisionet në të cilat gratë janë të nën-përfaqësuar, përfshirë komisionet me mandat për të mbikëqyrur mbrojtjen dhe sigurinë.

Sidoqoftë, do të ishte e gabuar të supozohet se gratë deputete automatikisht adoptojnë qasje më të përgjegjshme gjinore dhe më gjithëpërfshirëse gjinore ndaj mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë. Si burrat ashtu edhe gratë kanë paragjykime të vetvetishme gjinore, dhe mund të jenë njësoj të pavetëdijsëm për nevojat e sigurisë dhe cënueshmëritë e mundshme të njerëzve brenda komuniteteve me të cilat ata kanë pak kontakte personale. Ndërsa kuotat dhe masat e tjera për sigurimin e parlamenteve dhe komisioneve të ekuilibruara gjinore janë hapi i parë i rëndësishëm, është e domosdoshme që të gjithë anëtarët e komisioneve parlamentare të marrin mbështetje në ndërtimin e kapaciteteve për të adresuar paragjykimet e mundshme gjinore dhe për t'u bërë të vetëdijsëm për nevojat, sfidat dhe cënueshmëritë e grave, burrave, djemve dhe vajzave lidhur me sigurinë.

Fusnotat

1. UNDP (2016) *Guidance Note: Strategies and Good Practices in Promoting Gender Equality Outcomes in Parliament*, New York: UNDP, p. 5.
2. M. Kaufman (2014) "Engaging men, changing gender norms: Directions for gender-transformative action", MenEngage and UNFPA Advocacy Brief, p. 10.
3. J. Savike (2018) "Fijian Parliament to champion gender equality", *Fiji Times*, 4 December, <https://www.fijitimes.com/fijian-parliament-to-champion-gender-equality>.
4. UNDP (undated) *Scrutinising Legislation from a Gender Perspective: A Practical Toolkit*, Suva: UNDP, p. 3.
5. A. Fofana Ibrahim, A. Sivalie Mbayo and R. McCarthy (2015) "Integrating gender in security sector reform and governance", in O. Moderan and L. Boström (eds) *Toolkit for Security Sector Reform and Governance in West Africa*, Geneva: DCAF, shënimi 57, f. 76.
6. International Labour Office (2012) *A Manual for Gender Audit Facilitators: The ILO Participatory Gender Audit Methodology*, Geneva: ILO, p. 10.
7. DCAF (2011) "Gender and security sector reform: Examples from the ground", Geneva: DCAF, p. 65.
8. UNDP, shënimi 1 më lart, ff. 5-6.
9. Po aty, f. 8.
10. OSCE/ODIHR (2013) "A comparative study for structures of women MPs in the OSCE region", Warsaw: OSCE/ODIHR.
11. Intervistë telefonike me deputeten nga El Salvadori, Nidia Diaz (FMLN), 3 mars 2019; intervistë me deputeten nga El Salvadori, Gloria Salguero Gross (ARENA), San Salvador, El Salvador, 7 mars 2014.
12. Intervistë me deputeten nga El Salvadori, Nidia Diaz, 3 mars 2019.
13. Intervistë telefonike me Gisela Wurm, anëtare e Komisionit Parlamentar Austriak për Forcat e Armatosura Federale dhe Kryesuese e Komisionit Parlamentar për Barazi Gjinore (2008–2017), Austri, 13 tetor 2018.
14. W. F. van Eekelen (2010) "The democratic control of the armed forces: The national and international parliamentary dimension", in H. Born, P. Fluri and S. Lunn (eds) *The Relevance of Parliamentary Oversight for the Security Sector*, Geneva: DCAF, p. 58.
15. UN Women Georgia (2018) "Women's rights advocates in Georgia call for tougher response to femicide", 17 May, <http://georgia.unwomen.org/en/news/stories/2018/05/womens-rights-advocates-in-georgia-call-for-tougher-response-to-femicide>.
16. Po aty.
17. Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 25, lidhur me nenin 4, paragrafin 1, të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, për masat e veçanta të përkohshme.
18. Shih, për shembull, I. Luciak (2009) *Gender and Democracy in Cuba*, Gainesville, FL: University Press of Florida.
19. UNDP, shënimi 1 më lart, f. 1.
20. IPU/UN Women (2019) "Map of women in politics", <https://www.ipu.org/resources/publications/infographics/2019-03/women-in-politics-2019>; UN Women (2015) "Preventing conflict, transforming justice, securing the peace: A global study on the implementation of Security Council Resolution 1325", New York: UN Women; M. Bastick (2018) "Gender and security sector reform", in C. E. Gentry, L.J. Shepard and L. Sjoberg (eds) *Routledge Handbook of Gender and Security*, London: Routledge.



United Nations
Secretary-General's Campaign

UNITE to **END VIOLENCE AGAINST WOMEN**
ASIA-PACIFIC

strong hands stop violence against women and girls

Connect with us
FACEBOOK.COM/SAYNO.UNITE
TWITTER.COM/SAYNO_UNITE
ENDVIOLENCE.UN.ORG



6. Rekomandimet kryesore për integrimin e perspektivës gjinore në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë

- ✦ Të bëhet *analiza gjinore* e legjislacionit të sigurisë dhe prezantimi dhe forcimi i *nismave për buxhet të përgjegjshëm gjinor*.
- ✦ Të ndërtohen *kapacitetet gjinore të parlamentarëve meshkuj dhe femra*, veçanërisht anëtarëve të komisioneve të mbrojtjes dhe sigurisë, përmes kumtesave informative, trajnimeve dhe nismave tjera për vetëdijesim.
- ✦ Të mbështetet nënshkrimi, ratifikimi dhe implementimi i plotë i *traktateve dhe konventave ndërkombëtare dhe rajonale* që kërkojnë promovimin e barazisë gjinore në sektorin e sigurisë, siç është Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave.
- ✦ Të adoptohet *legjislacion efektiv për të adresuar dhunën në bazë gjinore kundër dhe nga gratë dhe vajzat, burrat dhe djemtë dhe individët me prejardhje të larmishme*, duke përfshirë atë lidhur me moshën, aftësinë e kufizuar, orientimin seksual, identitetet dhe shprehjet gjinore.
- ✦ Të përfshihet *komisioni parlamentar për çështje gjinore dhe grupi parlamentar i grave* në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë.
- ✦ Të arrihet *barazia gjinore brenda parlamentit* duke implementuar masa të veçanta të përkohshme siç janë kuotat, duke reformuar sistemet zgjedhore dhe duke mbështetur ndërtimin e kapaciteteve në radhët e partive politike dhe kandidatëve femra.
- ✦ Të rritet përfaqësimi i *grave parlamentare në komisionet e mbrojtjes dhe sigurisë*.
- ✦ Të përfshihet *shoqëria civile*, veçanërisht organizatat e grave, në hartimin e politikave të sigurisë përmes konsultimeve me bazë të gjerë, dëgjimeve publike dhe mekanizmeve të tjerë formalë dhe joformalë.
- ✦ Të bashkëpunohet me *institucionet e ombudspersonit dhe institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut* për të përfshirë njësimin e çështjeve gjinore në punën parlamentare.
- ✦ Të kërkohen, monitorohen dhe mbikëqyren *planet kombëtare të veprimit për Agjendën Gratë, Paqja dhe Siguria*.



7. Resurset plotësuese

Uebsajtet

DCAF <https://www.dcaf.ch>

I Know Politics www.iknowpolitics.org

International Development Research Centre www.idrc.ca

International Institute for Democracy and Electoral Assistance www.idea.int

Inter-Parliamentary Union (IPU) www.ipu.org

OSCE/ODIHR <https://www.osce.org/odihr/gender-equality>

UN Women www.unwomen.org

World Bank dataset on proportion of women parliamentarians <https://data.worldbank.org/indicator/SG.GEN.PARL.ZS>

Udhëzuesit dhe doracakët

Aguja, Mario and Hans Born (eds) (2017) *The Role of Parliament in Police Governance: Lessons Learned from Asia and Europe*, Geneva: DCAF.

Bastick, Megan (2014) *Integrating a Gender Perspective into Oversight of the Security Sector by Ombuds Institutions & National Human Rights Institutions*, Geneva: DCAF, OSCE/ODIHR, OSCE.

Bastick, Megan, *Gjinia dhe mekanizmat për ankesa: Doracak për Forcat e Armatosura dhe Institucionet e Ombudspersonit për parandalim dhe reagim ndaj diskriminimit, ngacmimit, bullizmit dhe abuzimit të bazuar në gjini*, Gjenevë: DCAF.

European Institute for Gender Equality (2019) *Toolkit on Gender-Sensitive Parliaments*, www.eige.europa.eu/gender-mainstreaming/toolkits/gender-sensitive-parliaments (accessed 1 September 2019).

Gentry, Caron E., Laura J. Shepard and Laura Sjoberg (eds) (2018) *Routledge Handbook of Gender and Security*, London: Routledge.

Ibrahim, Aisha Fofana, Alex Sivalie Mbayo and Rosaline MCarthy (2015) "Integrating gender in security sector reform and governance", in Ornella Moderan (ed.) *Toolkit for Security Sector Reform and Governance in West Africa*, Geneva: DCAF.

Foto: Pjesëtarët e publikut festojnë përparimet drejt aprovimit të ligjit për parandalimin dhe zhdukjen e dhunës me bazë gjinore ndaj grave në Kuvendin Kombëtar të Ekuadorit, 2017 © Alexander Moya/Asamblea Nacional del Ekuador.

Johannsen, Agneta M. (2009) "Training resources on parliamentary oversight of the security sector and gender", in Megan Bastick and Kristin Valasek (eds) *Gender and Security Sector Reform Training Resource Package*, Geneva: DCAF.

Moderan, Ornella and Lisa Boström (eds) (2015) *Toolkit for Security Sector Reform and Governance in West Africa*, Geneva: DCAF.

OSCE/ODIHR (2017) *Making Laws Work for Women and Men: A Practical Guide to Gender-Sensitive Legislation*, Warsaw: OSCE/ODIHR.

Palmieri, Sonia (2011) *Gender-Sensitive Parliaments: A Global Review of Good Practice*, Geneva: IPU.

UN General Assembly (2015) *Transforming the World: The 2030 Agenda for Sustainable Development*, New York: United Nations.

UN Women (2012) *Handbook for National Action Plans on Violence against Women*, New York: UN Women.

UN Women, WHO, UNDP and UNODC (2015) *Essential Services Package for Women and Girls Subject to Violence: Core Elements and Quality Guidelines*, New York: United Nations.

UNDP (2016) *Guidance Note: Strategies and Good Practices in Promoting Gender Equality Outcomes in Parliament*, New York: UNDP.

UNDP and Parliamentarians for Global Action (2017) *Advancing the Human Rights and Inclusion of LGBTI People: A Handbook for Parliamentarians*, New York: UNDP.

Artikujt dhe raportet

Ferbach, Sarah and Audrey Reeves (2018) "The role of parliaments in NATO member countries in advancing the Women, Peace and Security Agenda", Geneva: DCAF.

IPU and UNDP (2017) "Global parliamentary report 2017 – Parliamentary oversight: Parliament's power to hold government to account", Tignieu-Jameyzieu: Courand et Associés.

Kaufman, Michael (2014) "Engaging men, changing gender norms: Directions for gender-transformative action", Washington, DC: MenEngage and UNFPA.

OSCE Parliamentary Assembly (2018) "Gender balance report: Taking urgent action in the OSCE region to end gender-based violence", Berlin: OSCE.

